



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 766, datë 3.12.2019 “Për pezullimin nga detyra të një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.
Ne kuader të shqyrtimit të këtij vendimi, është thirrur për tu degjyar z.Arben Malaj
2. Shqyrtimi I Dekretit të Presidentit Nr.11343 datë 6.11.2019, për kthimin e ligjit nr. 7112019 "Për korporatën e investimeve shqiptare"

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Reme Lala,
Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi,
Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita,
Ylli Shehu, Sadi Vorpsi, Dritan Bici.

Mungojnë:

Anastas Angjeli

Të ftuar:

1. Z. Arben Malaj
2. Z. Jordan Daci

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj - ...na përcjellë zyrtarisht para disa ditësh, vendimi i Këshillit të Ministrave nr 766, datë 3, 12, 2019, “Për pezullimin nga detyra të një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Pra, unë po shpjegoj çfarë ka ndodhur deri tani. Pastaj, në bazë të procedurës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, media, ju lutem! Më falni!

Mirë atëherë, le të fillojmë edhe një herë, për shkak të prezencës së medias.

Mirë se erdhët, zoti Malaj!

Nga Shërbimet e Kuvendit, në bazë të procedurës, na është përcjellë...

Qetësi media, ju lutem!

Pra, na është përcjellë vendimi i Këshillit të Ministrave nr 766, datë 3, 12, 2019, “Për pezullimin nga detyra të një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Me shkresën nr. 2790 të datës 15, 7, 2018, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka depozituar në Kuvend propozim për shkarkimin e zotit Arben Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Me shkresën nr. 2791/1 të datës 16, 7, 2019, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, sipas autorizimit të dhënë nga Kryetari i Kuvendit, i ka përcjellë për kompetencë Këshillit të Ministrave kërkesën e nënshkruar nga 28 deputetë, për shkarkimin e zotit Arben Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Me vendimin nr. 766, datë 3, 12, 2019, Këshilli i Ministrave ka vendosur pezullimin nga detyra si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të zotit Arben Malaj.

Ky vendim i është përcjellë Kuvendit për vendimmarrje të mëtejshme.

Në lidhje me këtë praktikë, Shërbimi i Monitorimit ka sjellë në vëmendjen tonë dispozitat që rregullojnë kompetencën dhe procedurën e shqyrtimit si më poshtë:

Ligji “Për Bankën e Shqipërisë”:

1-“Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, neni 47, duke përfshirë guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët pezullohen nga detyra nga Këshilli i Ministrave dhe shkarkohen nga Kuvendi, në qoftë se ai ose ajo, gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive merr pjesë në...”

Do t'ju lutesha për qetësi!

“...në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.”

2. “Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga Kuvendi, me propozim të shumicës së gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur personi i propozuar për shkarkim, gjatë ushtrimit të detyrës, ka shkelur rëndë etikën e punës dhe ka cenuar thellë interesat e Bankës së Shqipërisë.”

3. “Në rast se anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët, është pezulluar prej detyrës nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi nuk e ka shkarkuar brenda 30 ditëve nga pezullimi, atëherë ky pezullim shfuqizohet dhe anëtari i pezulluar rifiton të drejtat dhe detyrimet menjëherë.”

Rregullorja e Kuvendit, neni 115: “Shkarkimi i anëtarëve të organeve të krijuara me ligj”.

1. “Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në ligj.

2. Kryetari i Kuvendit ia përcjell kërkesën, së bashku me dokumentacionin shoqërues, komisionit të përhershëm përkatës, i cili duhet të paraqesë një raport për seancën plenare brenda 4 javëve nga data e marrjes së kërkesës.

3. Shqyrtimi i çështjes në komision kryhet nëpërmjet një procedure, që i garanton personit që kërkohet të shkarkohet, të drejtën për t’u informuar në kohë, për t’u pyetur, për t’u dëgjuar, për të bërë pyetje ndaj kërkuesve të shkarkimit dhe për të paraqitur shpjegimet e tij.

4. Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim dhe, në rast se kërkohet nga një kryetar grupi parlamentar, edhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje, e cila në çdo rast duhet të jetë jo më vonë se 3 javë nga paraqitja e raportit të komisionit. Në rast se kërkohet nga vetë personi, nga 7 deputetë ose nga kryetari i një grupi parlamentar, personit ndaj të cilit kërkohet shkarkimi i jepet fjala në seancë plenare jo më shumë se 15 minuta.”

Gjithashtu, dua të vë në dijeni komisionin, se me datën 6, 12, 2019, zoti Arben Malaj ka depozituar në Kuvend kërkesën për të drejtën e fjalës në seancë parlamentare. Shkresa është protokolluar në Kuvend, me nr. 4316, datë 10, 12, 2019, bashkëlidhur materialeve që kemi.

Këtu po e përfundoj. Ju e keni dokumentacionin përkatës. Nëse i kemi të gjitha përpara dhe nuk ka ndonjë pyetje për materialin, në lidhje me mungesën ose jo të materialit, unë mendoj

të ndjekim procedurën, t'ia japim fjalën zotit Malaj. Pas zotit Malaj, nëse do të ketë ndonjë pyetje apo koment, t'ua japim fjalën anëtarëve të komisionit.

Zoti Malaj, ju lutem!

Arben Malaj – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Të nderuar deputetë,

Unë do të bëj trajtimin profesional në raport me propozimin, për të cilin ju mund ta thoshit se iniciuesi është vetë Kryeministri. Këtu ka një ngërç institucional, sepse çdo vendim i qeverisë vjen me dy firma. Vjen me firmën e propozuesit dhe me firmën e Kryeministrit.

Në këtë rast, cili është përfaqësuesi i qeverisë dhe cili është përfaqësuesi i Kryeministrit në këtë ballafaqim publik?

A mund të më ndihmoni ta kuptoj procedurën, zoti kryetar?

Arben Ahmetaj – Po. Ligji i jep të drejtë Këshillit të Ministrave, që të ketë prezent një përfaqësues. Këshilli i Ministrave është njoftuar për këtë seancë. Ka njoftuar se nuk do të sjellë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord! Besoj se unë do t'i referohem Kuvendit. Është e drejtë dhe jo detyrim sipas ligjit. Gjithsesi, unë ju njoftoj se nuk ka ardhur asnjë përfaqësues i Këshillit të Ministrave.

Arben Malaj – Zoti Ahmetaj, bazuar në përvojën time gjashtëmbëdhjetëvjeçare, kur vjen një projekt, siç është ky projekt ligjor, propozimi i Kryeministrit për shkarkim, i konvertuar me të drejtë brenda ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, në propozim për shkarkim, pala propozuese duhet të jetë në seancën ballafaqese, sepse unë nuk jam magazinier, por anëtar i një institucioni kushtetues të vendit tim. Rregullorja e parlamentit, por edhe principet kryesore të funksionimit të një shteti ligjor, më japin të drejtën të kërkoj që këtu të jetë përfaqësuesi, përfaqësuesi i qeverisë.

Ashtu siç ndodhte me ju, kur ishit ministër i Financave, dhe bëri një propozim për një ndryshim ligjor, dhe atë propozim e kthente në projektligj qeveria, ju si propozues ishit i detyruar të shkonit në komision. Ju personalisht keni debatuar me përfaqësues të qeverisë, me qëllim që të garantohej prezenca e propozuesit.

Unë nuk kërkoj të vijë Kryeministri. Në asnjë mënyrë jo. Kryeministri le t'u shërbejë atyre që kanë nevojë. Unë kërkoj që një person i noterizuar nga Kryeministri, të vijë e të mbrojë iniciativën e Kryeministrit në lidhje me propozimin për pezullim e shkarkim.

Jua bëj të qartë edhe një herë, se unë nuk dua asnjë qindarkë nga taksapaguesit shqiptarë, por mënyra se si Kryeministri nis një proces dhe e lë në mes, është një rrezik real për taksapaguesit shqiptarë nga një vendim penalizuese deri te Gjykata e Strasburgut.

Jam shumë i singertë, jam shumë serioz. Nuk kërkoj të vijë Rama këtu. Kërkoj që Rama, si iniciues, të autorizojë me prokurë personin që mbron iniciativën e tij ligjore.

Unë jam shumë i kujdesshëm me shkresat. Në vendimin e qeverisë thuhet që në kokë: “Me propozim të Kryeministrit”.

Kësisoj, zoti Ahmetaj, merrni përgjegjësinë tuaj për të garantuar funksionimin real të kësaj seance.

Arben Ahmetaj – Zoti Malaj, në dijeninë time në lidhje me teknikën ligjore dhe detyrimit ligjor, Këshilli i Ministrave ka të drejtë; pra ligji nuk e shpreh si detyrim. Gjithsesi, Këshilli i Ministrave nuk e ka dërguar, pra nuk ka menduar...

Arben Malaj – Janë dy palë: është Këshilli i Ministrave, është edhe propozuesi. Të lutem, mos i bashko në një!

Arben Ahmetaj – Zoti Malaj, ja ta mbaroj. Do të më falësh.

Arben Malaj – Po.

Arben Ahmetaj – Pra, nuk ka dërguar përfaqësues.

Arben Malaj – Po propozuesi?

Arben Ahmetaj – Propozuesi?

Arben Malaj – Kryeministri, përfaqësues të tij. Kujt do t’i bëj pyetje unë? Iniciativën e ka ndërmarrë Kryeministri. Por unë kujt do t’i bëj pyetje?

Arben Ahmetaj – Mund t’ua bëni pyetjet tuaja edhe deputetëve, sepse...

Arben Malaj – Jo, jo, propozuesit. Unë nuk kam asnjë problem me deputetët. Unë dua propozuesin. Siç dërgoni ju një ligj për ndryshimin e taksave, edhe deputetët në komision duan përfaqësuesin e Ministrisë së Financave, që ta pyesin. Unë nuk i di argumentet e Kryeministrit, nuk e kam procesverbalin e mbledhjes. E kemi kërkuar me shkrim, por nuk na e japin. Kemi kërkuar të drejtën e audios, në lidhje me çfarë është diskutuar dhe si është argumentuar. Këto janë të drejta elementare të një njeriu në proces shkarkimi.

Kështu që, të lutem shumë, regjistrojini, evidentojini, merrni kohën e nevojshme. Unë këtu jam. Megjithatë, avokati im do t’i sqarojë të gjitha çështjet, pasi të bëj prezantimin në këtë komision.

Arben Ahmetaj – Dakord!

Arben Malaj – Avokati ka diçka për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ta jap unë lejen, avokat. Një sekondë.

Zoti Malaj, në respektin tuaj e të marrëdhënies që...

Arben Malaj – Nuk kam marrëdhënie. Marrëdhëniet janë vetëm institucionale. Të uroj suksese në përgjegjësitë që merr. Marrëdhëniet janë vetëm institucionale.

Arben Ahmetaj – Për marrëdhënie institucionale fola.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – E drejtë! Do t’ju lutesha që të mbajmë procedurën, në mënyrë që ju të keni të drejtën të flisni në kohën tuaj, por edhe avokati. Në këndvështrimin tim, nuk është fare një procedurë që kërkon avokat, por ju e kërkuat, kështu që s’ka pse të mos jetë.

Po, zoti Avokat.

Arben Malaj – Një minutë! Ishte një kohë që ju mësoja unë juve, që të bëheshit i dobishëm për vendin, ndërsa tani po më mësoni ju mua nëse duhet apo nuk duhet avokati. Avokati duhet, sepse jam në një procedurë shkarkimi. Kështu që, ju lutem, mbajini konsideratat për diçka tjetër dhe le të vazhdojmë procesin normal. Dakord?

Arben Ahmetaj – Zoti Malaj, siç u referuat ju, në respektin tuaj, unë erdha i mësuar, mësova unë nga ju dhe ju nga unë, por nuk është ky thelbi sot. Nuk është ky thelbi sot, të lutem! Nuk dua të më referoheni mua. Unë dua të ndjek procedurën, t’ju respektoj institucionalisht, që të flasë avokati, të flisni ju, të bëjnë pyetje deputetët. Pra, të ecim në logjikën e procedurës.

Ju lutem, mund ta merrni fjalën kur të doni!

Jordan Daci – Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Unë kam vetëm dy gjëra proceduriale për të sqaruar, para se të vazhdojmë.

Në materialin ë kemi marrë nga Kuvendi ka dy iniciativa: njëra e Kuvendit, që i është dërguar për kompetencë qeverisë, dhe një vendim qeverie. A mund të na thoni, ju lutem, se kush është kërkuesi i shkarkimit, nga pikëpamja proceduriale, sipas Rregullores së Kuvendit? Cili është subjekti kërkues?

Arben Ahmetaj – Është një grup deputetësh, që kanë ndjekur procedurën në Këshillin e Ministrave. Unë kam këtu shkresën. Ju keni gjithë dosjen përpara. Referojuni asaj dosjeje. Ju ka ardhur zyrtarisht që të premtën, në mos gabohem. Është e vërtetë, zoti Malaj, ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jordan Daci – Edhe diçka, i nderuar!

Ne ia kemi kërkuar Këshillit të Ministrave, sepse pjesë e ligjshmërisë së këtij procesi është edhe ligjshmëria e vetë propozimit të Këshillit të Ministrave, konkretisht vendimit të Këshillit të Ministrave në fjalë.

Sigurisht, Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, së bashku me ligjin përkatës, përcakton detyrimin e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit elektronik të mbledhjes së Këshillit të Ministrave. Ne e kemi kërkuar, sepse kemi dyshimet tona se kjo pjesë procedurale ka parregullsi. Unë kam këtu një kopje të kërkesës, së bashku me dëftesën postare. Kërkojmë që, proceduralisht, referuar edhe Rregullores së Kuvendit, edhe Kodit të Procedurës Administrative, që ju e keni referuar në material, ndonëse kam mendim të kundërt në lidhje me zbatueshmërinë e tij, kërkojmë që para se të fillojë shqyrtimi, të na vihet në dispozicion, t'i kërkohej Këshillit të Ministrave, që e gjithë praktika e plotë të vihet edhe në dispozicion të anëtarëve, edhe në dispozicionin tonë, sepse gjykojmë se ka parregullsi e shkelje ligjore, sa i takon pjesës procedurale e vendimit të Këshillit të Ministrave.

Askush nga ne nuk është në gjendje ta gjykojë nëse ka paligjshmëri apo jo, pa këto dy dokumente, të cilët janë të rëndësishme për t'i pasur.

Arben Ahmetaj – Dakord! Qëndrimi juaj u regjistrua nga shërbimet e Kuvendit. Gjithsesi, besoj se ju do të ndiqni procedurën tuaj, ndërsa ne do të ndjekim procedurën ligjore, në bazë të ligjit.

Siç ju thashë, nismëtarët janë 28 deputetë. Në bazë të procedurës, i është kërkuar Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, siç u referova në momentin e parë, ka kthyer një vendim nr. 766. Në mos gabohem, data është 3, 12. 2019.

Unë do të dëshiroja t'ia jepja fjalën zotit Malaj. Ju lutem!

Arben Malaj – E para, zoti kryetar i komisionit, ju sqaroj se jeni në përplasje kompetencash dhe procedurash.

Është e vërtetë se me datë 15 korrik, 28 deputetë, bazuar në argumente shpifëse, gjë për të cilën kam mbajtur qëndrim publik dhe do të ndjek procedurat ligjore, kërkuan shkarkimin tim.

Po atë ditë, sipas Rregullores së Kuvendit, ku ka një kapitull të veçantë në lidhje me shkarkimin e anëtarëve të institucioneve kushtetuese, i kam kërkuar me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm, që të më vërë në dispozicion shkresën, që sipas deklaratës së Kryetarit të

Kuvendit, i kishim dërguar qeverisë. Për rreth katër muaj nuk kam marrë asnjë përgjigje. Çuditërisht, shkresa i është dhënë vetëm dje avokatit tim, duke e ditur se çfarë statusi të veçantë ka avokati, dhe çfarë statusi kam unë, si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

E dyta, që ju vë juve në pozicion të vështirë në këtë proces, është fakti se nga njëra anë pretendoni se ia keni nisur qeverisë, e në këtë rast duhej të kishte ngrirë procesi parlamentar, nga ana tjetër, sipas bisedës dhe kërkesës së drejtpërdrejt që ju kam bërë edhe juve, si kryetar i komisionit, disa herë me e-mail, por që nuk jeni përgjigjur asnjëherë.

Në programet e Kuvendit, në dy raste: nga korriku deri në mes të tetorit, dhe nga tetori deri më 13 dhjetor, ju keni parashikuar që komisioni i juaj dhe Komisioni i Ligjeve do të shqyrtonte kërkesën e deputetëve. As e keni shqyrtuar e as nuk keni dhënë ndonjë përgjigje, dhe çuditërisht, një ditë thoni se Kryeministri propozon sipas deputetëve.

Kryeministri ka iniciativën e vet personale, dhe ka marrë, ka kopjuar, si fotokopje të keqe, disa nga argumentet e deputetëve, por nuk thotë se e mbështet këtë kërkesë, por thotë: thotë: unë si Kryeministër, për qejfmbetje spontane. Në mes të natës kërkon të bëhet një mbledhje qeverie dhe të vendosë për shkarkimin tim.

Atëherë, së pari falënderoj për mundësinë që m'u dha për këtë komunikim publik. Një falënderim të jashtëzakonshëm për medien e vendit tim, si dhe për të gjithë ata që, nëpër rrjete sociale, më kanë dhënë mbështetje në këtë ballafaqim, i cili s'bëhet për një karrige, sepse kam pasur dhe kam lënë shumë karrige, e do të marr prapë të tjera, për bëhet të mbrojtur pavarësinë reale të Bankës së Shqipërisë.

Së dyti, shpreh ngushëllime nga zemra për të gjitha familjet që humbën të afërmit e tyre, dhe u uroj shërim të shpejtë të gjithë të plagosurve.

Ju uroj edhe juve suksese në lidhje me mandatin e Ministrit për Rindërtim.

I kërkoj ndjesë opinionit publik të vendit tim, që më ka inspiruar gjithmonë për të marrë detyra të vështira e për t'i përballuar ato me sukses.

Në këtë ballafaqim publik jam i inspiruar nga presidenti amerikan Xheferson, i cili thekson: "Gjithçka për të cilën tiranët (neodiktatorët në këtë rast) kanë nevojë për të mbijetuar, është heshtja e njerëzve me vetëdije të lartë."

Lidhur me procedurat, u sqaruan këtu dhe do të sqarohen nga avokati, sepse keni përplasje, duhet të sqaroni konfliktin ligjor, meqenëse nesër mund të kthehet në kosto për taksapaguesit shqiptarë.

Sigurisht, nuk është se them unë, por e thonë edhe studiuesit e shkencave politike, se neodiktaturat janë një rrezik, dhe se ato po rishfaqen në vendet ish-komuniste. Në vendet jodemokratike, sipas studimeve lidhur me pavarësinë reale të Bankës së Shqipërisë, të bankës qendrore, nëse pushteti përqendrohet në një dorë të vetme, pavarësia reale e tyre është e pamundur.

Në të gjitha përvojat dhe angazhimet e mia politike, që ditën e parë kur vura këmbën në politikë, në vitin 1991, në Partinë Socialiste të Vlorës, kam besuar dhe kam aplikuar faktin se transparenca është aleati më i madh i demokracisë, ndërsa e drejta e mendimit të lirë, fjala e lirë, ndarja, balanca dhe kontrolli i pushteteve, mbrojtja e pronës private, pavarësia e gjyqësorit, janë kolonat strukturore, në të cilat duhet mbështetur mirëqeverisja e vendit.

Meqë keni marrë një detyrë të vështirë, ju e dini se problemi kryesor do të jenë kolonat strukturore. Nëse tërmeti kishte të bënte me kolona strukturore fizike, qeverisja ka të bëjë me kolona strukturore morale.

Dëmtimi i kolonave strukturore nga keqqeverisja, nga qeveria e shokëve dhe për shokët, nga korrupsioni epidemik dhe kapja e shtetit, nga vrasja e fjalës së lirë dhe e mendimit të lirë, kudo që të ndodhë dhe sa herë që të ndodhë, në çdo vend që ka ndodhur ka prodhuar kriza ekonomike, sociale dhe politike.

Ne, ekonomistët, të bazuar në historinë qindravjeçare të krizave ekonomike dhe financiare theksojmë se një cent i investuar për parandalim vlen 1 milionë dëm kur kriza ndodh.

Parandalimi është strategjia më e suksesshme dhe më efektive dhe parandalimi nuk vjen asnjëherë nga heshtja, nuk vjen nga ndalja e kritikave. Pikërisht ky debat nuk është i sotëm, por është debat moral për të gjithë ata që janë të angazhuar në politikë, prandaj Aristoteli më ka inspiruar kur thekson se ka vetëm një mënyrë për të shmangur kritikizmin, mos bëj asgjë, mos thuaj asgjë dhe je thjesht asgjë.

Duke u përballur me shpifjet e 25 deputetëve dhe duke u përballur së fundmi me fermanin sulltanor për pezullimin dhe shkarkimin, unë gjej inspirim te poeti i madh gjerman Gëte, i cili thekson: “Në qoftë se ke humbur paratë, pak ke humbur, duhet punë që të tjera të fitosh. Në qoftë se ke humbur nderin, shumë ke humbur, duhet famë që mendimin e tjetrit të ndryshosh. Në qoftë se ke humbur besimin, biri im, më mirë të mos kishe lindur”. Pikërisht kjo më ka shërbyer në jetë dhe gjatë 28 vjetëve, në ballafaqim publik, në mandate të rëndësishme të tranzicionit të vështirë të vendit tim i kam shërbyer me dashuri maksimale, me profesionalitet dhe integritet maksimal

dhe me kredibilitet maksimal. Kështu që akuzat tuaja janë të lehta për t'u hedhur poshtë dhe ballafaqimi deri në Gjykatën e Strazburgut është gjëja më e lehtë për mua.

Lidhur me akuzat tuaja, që janë përmbledhur në mënyrë të fotokopjuar nga një dokument në tjetrin, ju sqaroj se ka dy kolona ku më akuzoni:

E para, se nuk paskam qenë publik për të sqaruar pavarësinë reale të Bankës së Shqipërisë apo të edukojta më mirë popullin shqiptar.

Kjo është krenaria ime. Unë nuk mora altoparlantën si Rama dhe të vija këtu e t'u përgjigjesha akuzave tuaja.

Është libri i profesorëve më të mirë në ekonomiksin e zhvillimit, është libri që shpjegon pse një vend i varfër mund të dalë nga varfëria kur qeveriset mirë dhe pse një vend, edhe pse ka pasuri natyrore, mund të mbetet përherë i varfër kur qeveriset keq.

Është krenaria ime dhe e familjes sime që në këtë libër, të bërë nga dy profesorët më të mirë në botë në ekonomiksin e zhvillimit, së bashku me Luljeta Minxhozin dhe akademikun shqiptar Abdylmenaf Bexheti, jemi në kopertinën e librit në përkthimin shqip, i cili është për studentët e Masterit profesional, studentët e Masterit shkencor, për deputetët dhe për politikëbërësit.

Akuzoni se nuk paskam qenë prezent në medie për problemet ekonomike. I kam muaj për muaj. Doni t'ua lexoj, por nuk dua t'ua shpërdorj kohën? Nuk ka pasur muaj ku nuk jam shprehur për zhvillimet ekonomike të vendit tim.

Politikat monetare dhe fiskale sot në kohët moderne nuk janë më aritmetikë, nuk janë tabela shumëzimi, por janë politika, të cilat në fund të fundit bëhen efektive vetëm kur kthejnë optimizmin dhe kur reduktojnë paqartësitë dhe pasiguritë.

Kur presidentin e Bankës Qendrore Europiane, që sapo u largua nga posti dhe u zëvendësua nga një zonjë e nderuar, e cila edhe pse është nën akuzë publike në Francë për 400 milionë dollarë, bordi i FMN-së nuk pranoi fare ta diskutonte dhe tha se ne nuk merremi me akuza që ngrihen prapa shpine, kur të ketë një vendim gjykate do të marrim vendimin tonë. Kështu që është diametralisht e kundërt ekpëriencia juaj.

Por kur e pyetën për eficiencën e politikave monetare, përgjigjja e tij ishte e qartë dhe konkrete: Ekonomia moderne zhvillohet në bazë të pritshmërive, jo në bazë të tabelave të shumëzimit.

Në këtë aspekt, prezenca ime publike ka qenë maksimale në analizën e ekonomisë dhe të zhvillimit të vendit tim, qoftë për politikat monetare, qoftë për politikat fiskale. Kam qenë publik

me debatin që Banka Qendrore e Shqipërisë nuk duhet të vonohet për të mbështetur ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve të vegjël, pasi tregjet financiare, ku përfshihen edhe tregjet bankare, kanë riskun potencial (tamam si ato filmat e Hollivudit me krizën e vitit 2008).

Ka dy vjet që vonohet dhe komisioni juaj, që duhet ta kishte në raportin e monitorimit, rri e diskuton se herë kam unë në media dhe çfarë kam thënë.

Sigurisht që për pjesën e kontributeve publike dhe analizat e thelluara profesionale të politikave monetare, të politikave financiare, të elementeve të keqqeverisjes në nivel vendor apo qendror, kam një kontribut të mirë, pozitiv dhe që më bën krenar dhe aspak nuk më frikëson me shpifjet e 28 deputetëve apo me fermanin sulltanor të Ramës.

E dyta, ju si komision, se është detyra juaj, (unë e kam drejtuar atë komision, zoti Ahmetaj), se Banka e Shqipërisë, sipas nenit 161 të Kushtetutës së Shqipërisë, është institucion kushtetues dhe pavarësinë reale të Bakës së Shqipërisë, duhet ta keni ju si detyrë kryesore, ndërsa shqetësimin kryesor, nëse cenohet pavarësia reale të BSH-së, nuk ua kanë lënë as juve, as parlamentit, por ia kanë lënë vetëm bordit dhe në rastet e skandaleve, ia kanë lënë qeverisë, e cila bën një pezullim.

A doni të dini raste pezullimesh? Ishte skandali seksual i shefit të FMN-së, që e zbritën me pranga nga avioni. Ishte skandali i guvernatorit të Bankës së Italisë, që me telefon ndërhyri në procesin e privatizimit të një banke. Ishte skandali, që e gjeti të papërgatitur ish-guvernatorin e Bankës Qendrore të Gjermanisë, ku, i ftuar nga një bankë tregtare në një ceremoni, nuk e dinte që bashkë me të kishte vajtur edhe djali me të dashurën dhe ata harxhuan 7 mijë euro, banka nuk ia kërkoi guvernatorit se kishte frikë mos krijonte ndonjë keqkuptim, por kur doli në shtyp, ai dha menjëherë dorëheqjen se është prekje e kredibilitetit. S'kam asnjë element të kësaj natyre.

Te kolona a jam apo s'jam aktiv në rritjen e kredibilitetit publik të BSH-së, në atë copë letër që keni shkruar thoni që gjithë bordi nuk është aktiv. Ku është tabela që tregon se cili nga anëtarët e bordit e paska plotësuar këtë detyrë që unë nuk e paskam plotësuar?

Unë nuk dua të penalizohen anëtarët e bordit. Sigurisht, u ndjeva shumë mirë që guvernatori, pasi u sigurua që 28 deputetë do të kërkonin shkarkimin tim, dhe për mungesë përvoje, në mbledhjen e datës 7 gusht 2019, ku unë u kërkova me shkresë, edhe juve zoti Ahmetaj, edhe qeverisë, edhe parlamentit që në mbledhjen e parë, pas kërkesës së 28 deputetëve, ministri i Financës, që në bazë të ligjit të BSH-së ka të drejtë të marrë pjesë pa të drejtë vote, të vinte dhe të dëgjonte shqetësimin tim lidhur me cenimin real të pavarësisë së BSH-së nga kërkesa e 28

deputetëve. Asnjëri nga ju nuk reagoi, kjo për mua nuk ka rëndësi, por kjo tregon se unë e dua më shumë BSH-në se reagoj, ndërsa duke mos kthyer shkresa dhe duke mos trajtuar probleme, ju nuk e doni BSH-në, por doni karrigen e anëtarit të këshillit mbikëqyrës të BSH-së.

Për vlerësimin që keni bërë, që unë si anëtar nuk kam plotësuar asnjë nga detyrimet e mia për miredukimin e popullatës apo për prioritet e BSH-së, të ketë një tabelë krahasuese, këtë do ta kërkoj me shkrim, në mënyrë që guvernatori, edhe një herë e theksoj, pasi u garantua se mund t'i nxirrte gështenjat me duart e 28 deputetëve, në mbledhjen e radhës deklaroi se: “Ju jeni një vlerë e shtuar. Këshilli mbikëqyrës nuk ka asnjë shqetësim. Ne jemi shumë të kënaqur me kontributin tuaj.”

Kopjen e procesverbalit e disponoj të plotë. Në qoftë se nuk ua jep BSH-ja, jua jap unë.

Lidhur me kolonën e dytë, për akuzat politike, edhe një herë e theksoj se e drejta e mendimit të lirë, e drejta e fjalës së lirë, e drejta për të folur si qytetar, e drejta për të folur si banor i zonës, e drejta për të folur për çdo aspekt të jetës shoqërore dhe politike, pa akuza (siç ziheni ju në parlament), pa epitete banale (që përdorni ju me njëri-tjetrin në parlament) kam dhënë vlerësimet e mia për çdo ngjarje, qoftë në nivel vendor, qoftë në nivel qendror. Nuk kam guxuar dot të jap mendime të vlefshme në nivel global.

I injoroj totalisht akuzat politike. Mbetem te akuza profesionale dhe jam i gatshëm për çdo pyetje.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Malaj!

A ka ndonjë pyetje? Koment?

Urdhëroni, Suzana!

Suzana Topi – Faleminderit për prezencën, zoti Malaj!

Në bazë të ligjit të BSH-së dhe nenit 47, guvernatori, zëvendësguvernatorë, si dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së mund të shkarkohen vetëm nga shumica e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, në rast se është shkelur etika në punë, si dhe është cenuar rëndë interesi publik i bankës.

Në asnjë rast, nga relacioni që unë kam përpara, i sjellë nga Këshilli i Ministrave, nuk shikoj, në vlerësimin e sjelljes, që të jetë shkelur Kodi i Etikës apo interesat e BSH-së.

Në këtë kuadër, dua t'ju bëj tri pyetje:

1. Si një ish-punonjëse e bankës unë njoh mirë etikën në punë, rregullat e sjelljes, integritetin moral, profesional që punonjësit, apo në rastin tuaj, një funksionar publik i emëruar nga Kuvendi, duhet të ketë në funksion të BSH-së. Në këndvështrimin tim ju i plotësoni të gjitha këto. Pyetja është: A është mbledhur ndonjëherë këshilli mbikëqyrës për të analizuar dhe shqyrtuar rregullat e sjelljes ndaj jush? A keni ndonjë masë disiplinore të marrë nga ky këshill?

2. A mendoni se daljet publike kanë pasur ndikim negativ dhe keni cenuar interesat e thella të BSH-së?

3. A është ky një veprim i pastër politik për shkak të kritikave dhe qëndrimeve tuaja ndaj Kryeministrit, sepse ju jeni pezulluar jo me vendim të bordit, por me vendim të Këshillit të Ministrave?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti Malaj!

Arben Malaj – Faleminderit!

E para dhe mbi të gjitha kam qenë unë, në mënyrë të përhershme, që ditën e parë kur kam marrë mandatin, por edhe përgjegjësinë nga Kuvendi si anëtar i këshillit mbikëqyrës të BSH-së, që kam kërkuar të kishte një fokus më të mirë lidhur me elementin thelbësor, që është mirëqeverisja e BSH-së.

Sigurisht, jam pritur me këmbët e para nga administratorët dhe këto janë të protokolluara, sepse është menduar se duke ardhur një me status ish-ministri, me përvojë deputeti, do të krijohej ndonjë lloj ballafaqimi i vështirë për ta.

Jam ndier aq keq, sa, siç do të vërtetohet edhe publikisht, (se unë mendoj se transparenca është thelbi dhe qeverisja demokratike është ajo që duhet të përmirësohet në të gjitha institucionet, duke filluar nga BSH-së.

Libri “Pushteti i pazgjedhur” është shkruar nga zëvendësguvernatori i Bankës së Anglisë me 35 vjet përvojë në sistemin bankar, i cili paralajmëron që duhet të bëjmë shumë kujdes me pushtetet e pazgjedhura dhe duhet të përcaktojmë saktësisht mirëqeverisjen e tyre, sepse politikat monetare janë një e mirë publike.

Nëse një vend qeveriset mirë me politikat financiare dhe monetare, përfitojnë të gjithë shqiptarë, jo vetëm politikanët. Nëse një vend qeveriset keq, atëherë kostot i paguajnë taksapaguesit shqiptar.

Kam kërkuar të përsoset mirëqeverisja e enteve publike, ku bën pjesë edhe banka e qeverisë. Direktivat janë të ECD-së dhe mentaliteti i vjetër që banka qendrore është diçka e fshehtë për të cilën s' duhet të dihet asgjë ka rënë gjithnjë e më shumë.

Në një prononcim publik jam shprehur se, po të kishit mundësi ju deputetët që nënshkruat, mund të kishit shkarkuar edhe Papa Françeskun, sepse ai bëri një gjë të madhe, ndryshe nga Banka Qendrore e Shqipërisë, ai po demokratizon një nga bankat më të fshehta, që është Banka e Vatikanit.

Ky është një debat që bëhet kudo në botë dhe i gjithi është në favor të demokratizimit të qeverisjes së BSH-së.

Lidhur me pyetjen tuaj se a e kam cenuar unë, theksoj se në shkenca, por edhe në logjikën formale, thuhet se një që nuk matet nuk ekziston.

Nuk shoh asnjë tregues që të ketë matur se në ç'mënyrë apo në ç'masë, unë me qëndrimet e mia publike, që i mbroj të gjitha një nga një, kam cenuar interesat e BSH-së, pavarësisht se mund të mërzhitet në ndonjë rast Taulant Balla dhe lali Eri. Ju deklaroj këtu se i mbroj të gjitha një për një. Po të duan, të guxojnë të më bëjnë padi penale dhe të shkojmë të ballafaqohemi në gjyq. Nuk do të hesht për atë që duhet të bëhet më mirë në vendin tim.

Kur thashë se një gjë që nuk matet, nuk ekziston, desha të theksoj se, nëse do të kishte tronditje në BSH, do të kishte tronditje si në rastin e shefit të FMN-së, Domenik Shtraus Kan. Në qoftë se do të kishte tronditje nga qëndrimet e mia, do të kishte mungesë efieience të politikave monetare.

Kur vendi është në krizë dhe duhet të hedhësh më shumë para në ekonomi, ne kemi ulur në maksimum normat e interesit, ndërsa qeveria e ka të pamundur të hedhë më shumë para, se ne e dimë që borxhi është i shëndetshëm për aq kohë sa nuk vret rritjen ekonomike dhe nuk bëhet një barrë e rëndë për qytetarët. Pra, nuk ka ndonjë element të matshëm sa unë kam cenuar funksionimin e Bankës së Shqipërisë në politikat monetare, në kursin e këmbimit, madje monedha kombëtare është forcuar më shumë sa ekspertët mendojnë se është e natyrshme), pra është një vend që ndjen krenari kur monedha kombëtare forcohet (në depozita nuk ka rënie dhe depozitat nuk i siguron as guvernatori, as BSH-ja, por i garanton ligji “Për sigurimin e depozitave” që ne si qeverisje socialiste e bëmë dhe Berisha me Boden e alarmuan aq shumë sistemin bankar, sa duhej të ndërhynte ambasadori amerikan, Limprecht, për të ndalë panikun që

ata dëshironin, që pas firmave piramidale të bënin një krizë të re. Historia harrohet shpejt, por mbetet e shkruar.

E dyta, kam kërkuar të përmirësohet kodi. Ka një kod etike, por është i paqartë, ka një kod etike që duhet, e kemi kopjuar diku. Është tjetër Kodi i Etikës për punonjësit dhe është tjetër për anëtarët e këshillit mbikëqyrës që zgjidhet nga parlamenti, pra nuk mund të jetë drejtori i Burimeve Njerëzore, që emërohet nga bordi, personi përgjegjës ku unë duhet të paraqes ankesën.

Unë jam burokrat dhe i kam të gjitha shkresat, madje besoj se Ahmetaj ka mësuar një çikë nga burokracia ime. Kështu që, në këtë aspekt, i kam kërkuar me shkrim, cili është institucioni në këshillin mbikëqyrës të BSH-së që të shkrehë shqetësimin tim, se ndërmjet luftës që po më bëhet politikisht, cenohet pavarësia reale e BSH-së.

Pavarësia reale e BSH-së realizohet nga pavarësia reale e anëtarëve të saj, nuk garantohet nga fortësia e godinës apo nga lloji i xhamit të dritareve. Nuk kam asnjë masë, madje kemi bërë një debat në Këshillin Mbikëqyrës dhe kemi kërkuar të përmirësohet baza ligjore. Ka modele të ndryshme. Është modeli francez që unë e kam ndarë me Këshillin Mbikëqyrës të BSH-së, që identifikohet një personalitet në fushën e zbatimit të kodit etik dhe mund të merret si i jashtëm nga Këshilli Mbikëqyrës i një banke dhe të angazhohet për një rast të caktuar. Nuk ka pasur asnjë rast të tillë. U ndjeva shumë krenar në vitin 2016 kur u votova me 107 vota nga gjithë deputetët e parlamentit shqiptar, u ndjeva shumë krenar kur në Këshillin Mbikëqyrës të BSH-së pas akuzës së 28 deputetëve, guvernatori, në mënyrë shumë solide, por edhe anëtarët vlerësuan faktin që unë jam një vlerë e shtuar në Këshillin Mbikëqyrës të BSH-së (besoj se nuk e kanë ndryshuar mendimin).

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Lita!

Korab Lita - Faleminderit!

Kam një opinion më shumë sesa pyetje.

Po mundohemi që të gjejmë arsyet, por nuk po shoh se ka arsye profesionale apo administrative, të cilat kanë çuar në këtë vendim të KM-së.

Unë nuk do të flas për pjesën profesionale, pasi ajo dihet, ju jeni një vlerë e shtuar e BSH-së. Nuk do të thotë asgjë se, politikisht, ju i përkisni një krahu tjetër politik.

Kjo më ngjan me ato seancat e grupeve armiqësore që zhvilloheshin në kohën e komunizmit pikërisht në këtë ndërtesë dhe duket qartë se kjo ka ardhur pikërisht nga subjekti juaj politik, të

cilit ju i keni shërbyer për rreth 30 vjet. Kjo mua më ngjan me gjyqin që bëhej në kohën e komunizmit. Fati e ka sjellë që ju të jeni një ndër ta, por edhe në kohën e komunizmit, kur bëheshin këto gjyqe, personat që gjykoreshin i kishin shërbyer pushtetit.

Të kthehem të pjesa procedurale. Me sa dëgjova nga ju dhe po e shoh edhe në dokumentacionin që kemi në dispozicion, nuk janë dokumentet që ju kërkonin dhe besoj se, duke qenë se jemi në demokraci, keni krejt të drejtën ligjore dhe morale që t'ju vihen në dispozicion këto dokumente, që të jeni i bindur edhe proceduralisht se pse ka ardhur ky vendim.

Nëse është e mundur, unë do të kërkoja shtyrjen e seancës, dhe pasi të vihen në dispozicion dokumentet, të kemi një proces më të rregullt proceduralisht.

Faleminderit!

Artur Roshi – Faleminderit, kryetar!

(Ndërhyrja pa mikrofon)

Arben Malaj - Zoti Ahmetaj, a mund të flas?

Unë kërkoj që stafi juaj, stafi i Kuvendit të depozitojë kërkesën e kolegut deputet, nuk e shikoj nëse është demokrat apo socialist, por e shikoj të mandatuar në institucionin më të lartë të demokracisë së një vendi që duhet të jetë Kuvendi.

2. Është kërkesë e përsëritur edhe nga ne.

3. Vazhdimin e mbledhjes pa garantuar (kjo është përgjegjësi juaja si kryetar i Komisionit) tërësinë e dokumentacionit që kërkojmë, se ky ngjan në fakt me një gjyq partizan. Unë babanë e kam pasur partizan, pastaj e përjashtuan nga partia, pra vazhdon trashëgimia. Duhet ta vendosni ju, por në një kohë të dytë kjo do të jetë një nga pikat që shqyrtimi në këtë seancë është cenuar rëndë nga mungesa e mosdhënies së tërësisë së dokumentacionit personit, i cili thirret këtu për t'u ballafaquar me propozimin e Kryeministrit të Shqipërisë.

Unë do të doja një prononcim tuajin lidhur me këtë kërkesë që është jo vetëm e një deputeti, ka qenë e avokatit dhe po e përsëris edhe unë si pala kryesore në këtë seancë.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi - Faleminderit, zoti kryetar!

Profesor Malaj, ne të gjithë këtu e kemi të qartë se për sa i përket planit tuaj profesional, nuk besoj se ndonjëri nga ne këtu, por edhe përtej nesh, edhe më të aftë se ne, mund të thotë se

profesor Arben Malaj nuk i shërben bordit të Bankës së Shqipërisë, Këshillit Mbikëqyrës apo këtij institucioni financiar të rëndësishëm të vendit.

Ajo që del nga i gjithë problemi i ngritur është thjesht çështje politike, por sërish unë nuk dua të mbetemi peng i kësaj gjëje. Nëse shikojmë Rregulloren e Etikës, që është e vjetër, e vitit 2003, për mua duhet të ishte *update*-uar, sepse kanë ndryshuar kohët dhe kur ndryshojnë kohët duhet të ndryshojnë edhe rregulloret në përputhje me ecurinë, zhvillimin, liritë që fiton individi brenda institucionit dhe brenda të gjithë shoqërisë. Në këtë kontekst, këtu besoj se rrotullohet problemi: rreth lirisë së individit të një institucioni kaq të rëndësishëm siç është Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Liria e individit për mua është substanciale, sepse suksesi i një shoqërie shihet sesa është diapazoni i kësaj lirie. Këtu me këtë matet suksesi i një shoqërie, me diapazonin e lirisë së individit brenda institucioneve dhe në kontekstin shoqëror. Në Rregullore thuhet: “Edhe kur bëhen shkrime akademike nga një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës duhet të vendoset shënimi në fund që ky është opinionimi im personal”. Kjo besoj se është e qartë edhe për të gjithë deputetët në komision, nëse do ta sjellim në kontekstin e sotëm kohor, përveç medias së shkruar që është pasur parasysh në vitin 2003 kur është hartuar rregullorja, sepse atëherë funksiononte më tepër media e shkruar dhe 2-3 medie kanë qenë vizive, sot kemi medie vizive, përveç atyre të shkruara. Duke e sjellë në kontekstin e sotëm kemi dy plane: kemi medien e shkruar dhe medien vizive. Pra, nuk ka ndodhur ndonjë gjë edhe jashtë rregullores, vetëm se është shtuar medie vizive, atje ku është shprehur profesor Malaj. Çfarë do të thotë kjo? Nuk besoj se kur ka dalë në medie profesor Malaj ka thënë: “Unë po shpreh mendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”, kur ka folur për qëndrime të tjera. Ajo që ka prekur maxhorancën tërësisht është dalja juaj në medie në periudhën e rrezikshme të 30 qershorit, periudhë në të cilën janë zhvilluar zgjedhjet lokale.

Për atë që sa ju kam ndjekur si qytetar, besoj se keni qenë korrekt dhe jeni shprehur: “Këto janë qëndrimet e mia personale”. Megjithatë kam një pyetje në këtë drejtim, për ta pohuar, për të qenë korrekt me komisionin, pavarësisht nga objeksioni im. Më tej dua të them se përderisa flasim për lirinë e individit ne duhet ta ridimensionojmë atë në përputhje me kohën. Asnjë fjalë tjetër nuk thuhet te relacioni i deputetëve, te relacioni i Këshillit të Ministrave që ka të bëjë me ndonjë gjë tjetër, për të mos thënë se aty është një amulli e plotë, ka shumë fjalë të detajuara se gjoja “djalli fshihet në detaje”, por nuk ka asgjë konkrete, thelbësore që të ketë të bëjë me logjikën e një shkarkimi. Shkarkimi nuk vjen nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, nga 2 apo 3.

Ky është thelbi i ligjit, mënyra sesi funksionon institucioni, ndërsa kur vjen nga Këshilli i Ministrave sipas meje, është për ta zhbllokuar institucionin kur ka ngërç. Ne nuk jemi në një ngërç të tillë, as të institucionit, as se ka ndodhur ndonjë skandal nga zoti Malaj dhe nuk e zgjidhka dot institucioni, siç është Këshilli Mbikëqyrës, por do ta zgjidhë një institucion ekstra siç është Këshilli i Ministrave. Besoj se kjo është logjika, mënyra sesi është ndërtuar. Unë mendoj se nuk jemi në një rast të tillë që të ketë cenuar rëndë etikën. Çfarë duhet të kuptojmë me “ka cenuar rëndë etikën”? Që ka dalë dhe ka shprehur mendimet e tij, qoftë edhe politike? Njeriu mbi të tjerat është dhe qenie politike, pavarësisht se fshihemi pas saj. Këtë gjë e ka thënë Aristoteli dhe asnjë nga ne nuk duhet t’i shmanget asaj si qenie njerëzore, por problemi është se kur flasim për zhvillimet ekonomike, sigurisht një njeri që ka eksperiencë dhe thotë se: “Nuk përfaqësoj institucionin ku marr pjesë”, është i lirë të thotë çfarë të dojë. Ndryshe, ne kthehemi disa vjet mbrapa. Bie sërish dakord me ju personalisht që po ju dënon partia juaj.

Faleminderit!

Arben Malaj - I dashur deputet, mos na fut te politika! Shpresoj shumë që në këtë gjendje të keqe që është vendi ynë, ajo që duhet, e para është se duhet të dalim nga llogoret partiake.

Unë e kam bërë atë, kur kam pasur mandatet e mia qeverisëse, dhe nuk i kam parë stafet e mia as se ishin të majta apo të djathta, por i falënderoj nga zemrat stafin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë që me përkushtimin e tyre më ndihmuan që të isha i suksesshëm!

Lidhur me sqarimin që Banka e Shqipërisë e trajton në këndvështrimin e saj se kur shkruan një artikull, duhet të shkruash poshtë: “Nuk janë mendimet e Bankës”, ky është një rregull që e përdorin të gjitha institucionet akademike, si FMN-ja, Banka Botërore, apo jo Ahmetaj?! Punonjësit e tyre, drejtuesit e tyre shkruajnë dhe thonë: “Ky është mendimi im personal”. Nuk shpreh pikëpamjet. Ai që është gabim... Por nuk dua të hyj në detaje me Bankën e Shqipërisë, pasi Banka e Shqipërisë është shumë më e shtrenjtë sesa karrigia e 9 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ajo kërkon dashurinë dhe përkushtimin tonë dhe jo debatin tonë për atë që duhet të bëjë më mirë. Nga pikëpamja akademike ajo është për t’i nxitur njerëzit që të shkruajnë. Shkruani dhe mos hezitoni, por shkruani dhe qartësojeni. Kur shkruhet në emër të institucionit, e miraton një nga titullarët në nivelin më të lartë, e shkruan punonjësi, e miraton shefi, e shkruan shefi, e miraton drejtori, e shkruan drejtori i Përgjithshëm, e miraton zëvendësguvernatori. Kjo ruan bankën si institucion nga mendime të ndryshme, sepse kur ka

studime nuk ka një politikë monetare të vetme, nuk ka një politikë të vetme për kursin e këmbimit, nuk ka një të vetme për eficiencat e politikave monetare. Studiues të ndryshëm edhe brenda institucionit, kanë këndvështrime të ndryshme. Ata i nxisin që të shkruajnë, por për aq kohë sa punimi i tyre shkencor nuk është kthyer në një politikëbërje u kërkojnë që ta mbajnë si idenë e tyre. Ajo nuk është për të penguar, por është për të nxitur që të shkruajnë.

Lidhur me statusin politik, e kam thënë edhe një herë publikisht dhe e përsëris këtu: jam qenie njerëzore, jam qytetar, dua jetën time të përditshme ta kem sa më të lirë dhe pa asnjë pengesë, pa 490 mijë gjobat që vë bashkia e Tiranës si plan për të paguar punonjësit e saj. Jo! E kam thënë dhe e them publikisht përballë shqiptarëve: shqiptarët meritojnë të qeverisen me zemër, jo me arrogancë dhe jo me babëzi, përndryshe paniku do të krijojë probleme.

E para, është mungesa e besimit.

E dyta, është fluksi i lartë i atyre që largohen nga vendi. Një vend, (e kam shkruar, pa statusin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës), kur braktisja kthehet në qëllim në vetvete, një vend që humbet kapitalin social dhe human është një vend që vrapon drejt një krize më të thellë.

Lidhur me statusin politik, ligji “Për Bankën e Shqipërisë” është bërë me model europian. Varianti i parë është bërë në vitin 1997, Shqipëria ishte në kaos dhe ne nga njëra anë menaxhonim krizën dhe nga ana tjetër krijonim kuadrin ligjor dhe institucional që vendi të dilte nga kriza dhe të zhvillohej. Ahmetaj e mban mend mirë, se ka punuar në atë kohë shumë fort me mua dhe ai ligj është bërë në vitin 1997, se vinim nga një krizë e madhe.

Për çfarë reputacioni flasin këta që kanë frikë nga Banka e Shqipërisë kur flet një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës? Banka e Shqipërisë është i vetmi vend në të gjitha vendet në tranzicion që ka kaluar krizat më të madhe të kredibilitetit të saj dhe qytetarët shqiptarë nuk janë trembur dhe askush nuk mund t’i trembë qytetarët shqiptarë për të fshehur problemet që mund të ketë menaxhimi i çdo ministrie, i çdo institucioni dhe i Bankës së Shqipërisë. Është banka që është vjedhur më shumë se çdo bankë tjetër qendrore në vendet e Europës, është banka që ka më shumë administratorë, guvernatorë dhe zëvendësguvernatorë të arrestuar, të dënuar, pastaj edhe të dalë të pafajshëm. Çfarë kredibiliteti iu cënuaka Bankës së Shqipërisë që unë flas dhe kritikoj atë që duhet të bëhet më mirë?! Ligji “Për Bankë e Shqipërisë” më lejon të jem anëtar partie. Nuk thotë një anëtar. Unë nuk jam. Kam bërë zgjedhjen time dhe nuk jam. Do të pres ndryshimin e Kodit Zgjedhor, kur të hapet sistemi zgjedhor dhe të bëhet më demokratik do ta

shikoj raportin me vendin tim, ku i shërbej më mirë: si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, apo në një lëvizje të re politike, apo përfaqësues i një partie politike?

Ligji është modern, më lejon mua të punoj edhe në bankë private, mjafton që të mos ketë më shumë sesa 5% sistem bankar. Nuk është ligj komunist, por është ligj që është bërë me ekspertizë nga FMN-ja, nga Banka Botërore, nga bankat qendrore dhe është bërë i tillë që t'i japë bankës qendrore kredibilitetin, por edhe instrumentet maksimale që të jetë sa më e dobishme për vendin e saj. Në këtë aspekt unë nuk shoh asnjë pengesë.

Pajtohem me ju, me shqetësimin se po qeveriset me përqendrim gjithnjë e më shumë të pushtetit në një dorë. Jo rastësisht bordi apo Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka një konfigurim me 3 institucione, 5 i ka parlamenti, sepse është vota më e drejtpërdrejtë e qytetarëve shqiptarë, 3 i ka qeveria dhe 1 e ka vetë banka. Pra, janë 3 institucione që duhet të krijojnë një ekuilibër për ta mbrojtur Bankën e Shqipërisë nga goditjet politike ose nga interesat, nga duar të zgjatura për interesa jo profesionale në menaxhimin e Bankës së Shqipërisë, por nuk dua të flas këtu për gjëra specifike në raport me administratorët e bankës, të cilët në mënyrë të përsëritur kanë tentuar të më kufizojnë mundësinë që t'i shërbej vendit tim dhe të plotësoj mandatin që më dhatë ju.

Nuk kam kërkuar të shkoj përsëri në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe korrespondencën që kam bërë e ka edhe Ahmetaj, sepse ishte kryetar i Komisionit dhe duhej që ta kishte atë. Në vitin 2014 dëshiroja të shërbeja, por nuk më votoi Partia Socialiste. Deklarata ime është publike në shtyp, duke e ditur frikën që kanë deputetët nga liderët me pushtet absolut thashë: “Nëse do të më votojnë, do t'i falënderoj, nëse jo, do t'i mirëkuptoj”.

Në vitin 2016 u krijua një mundësi, më ftuan që të shkoja në bordin e Bankës së Shqipërisë. Është hera e parë, që kam ndjerë, (këtu kam një mesazh për deputetët e opozitës reale, sepse përderisa jeni në parlament ju jeni opozita reale), vlerësimet që më kanë bërë anëtarët opozitarë të komisionit, kanë qenë të tilla, sa më kanë bërë që të rimendoj pozicionet që duhet të kemi në raportet shoqërore me njëri-tjetrin. Ishin vlerësime maksimale, jam votuar me 107 vota, pa asnjë votë kundër. Shërbeva vetëm 2 vjet, erdhi viti 2018 nuk kishin ndërmend që të më votonin, e ndanë në pjesë votimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës: pesë do t'i votonin një ditë dhe unë do të isha i gjashti. Sigurisht me 27 vjet eksperiencë unë di të lexoj edhe nëpër rreshta. Në atë kohë i kam kërkuar Kryeministrit të Shqipërisë dhe Kryetarit të Kuvendit: “Unë nuk e kam merak nëse do të jem apo jo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të

Bankës së Shqipërisë”, por nëse ju nuk më votoni bashkë me 5 të tjerët, por më lini mënjane, pra të bëhej bordi me 8, e latë 2 muaj me 3 vetë, në mënyrë jo funksionale bordin e Bankës së Shqipërisë, këtu përgjegjësia është e Komisionit të Ekonomisë që duhet ta ndjekë hap pas hapi që të mos ketë asnjë krizë institucionale, pastaj propozuat 4, bashkë me shokun Bode 5 dhe mua më latë jashtë me idenë se do të votohesha i vetëm. Unë e kuptova shumë qartë se pasi të votonin pesë, unë nuk do të votohesha më, gjërat do të zvarriteshin. Në këtë mënyrë, në respekt të familjes sime, sakrificave të familjes sime për mandatet e vështira deri në kërcënime familjare, sepse për të ikur familja ime në Amerikë procedurat i ka zbatuar Ahmetaj, me ata që kërkuan të ikte urgjentisht se kërcënohej njësoj si familja e një profesori tjetër. Gjërat nuk janë kaq të lehta sa i shikoni. Ngrihet natën Edi Rama dhe i nis një sms Erion Braçes dhe i thotë: “Nesër në mëngjes të shkarkoni Arben Malajn!”. Jo, jo nuk janë aq të kollajshme.

Kështu që në këtë aspekt, unë e sqaroj edhe njëherë: procedurat i keni të gabuara. Pjesën politike nuk e diskutoj këtu. Kolegët e opozitës të mos më provokojnë fare. Pjesën politike do ta bëj vetëm në parlament, sepse në kulturën time, në edukatën time institucionale, ju jeni komisioni për pjesën thellësisht profesionale. Atje pastaj, i kam thënë shokut Edi Rama, me poezinë e Reshat Arbanës, se i vumë edhe statujën Ali Asllanit në Vajzë të Vlorës, do t’ia qartësoj se çfarë është duke u bërë keq dhe pse duhet ndaluar sa më parë për të mirën e tij dhe për të mirën e shqiptarëve.

Pra, te pjesa partiake, mos më provokoni kot. Unë jam i majtë, i përkas së majtës, raportet e mia me të majtën nuk më kanë kushtëzuar me asnjë karrige politike apo profesionale.

Avokati ka diçka për pjesën ligjore.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Malaj!

Po, ju lutem!

Jordan Daci- Faleminderit!

Gjykoj se kjo procedurë ka filluar gabim nga pikëpamja procedurale. Së pari, kemi dy propozues, në fakt vetë Kuvendi ia ka dërguar për kompetencë Këshillit të Ministrave. Pastaj Këshilli i Ministrave duke qenë se ne kemi të drejtën në bazë të Rregullores që sapo u citua që t’i bëjmë pyetje kërkuesit, sigurisht që ne pyetjet kërkuesit nuk do t’ia bëjmë me korrespondencë. Pra, do të duhej të sigurohej prania.

Së dyti, pjesa e dokumentacionit, të procedurave të ndjekura nga Këshilli i Ministrave, për të cilat ne gjejmë dhe kemi arsye të mjaftueshme për të dyshuar se janë të paligjshme, duhej të ishin patjetër pjesë e shqyrtimit.

Për t'u futur në pjesën e procedurës, përsëri për sa i përket Rregullores, konkretisht neni 114 i Rregullores së Kuvendit parashikon: “Kërkesën për shkarkimin e anëtarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë”. Mjafton të lexoni nenin 161 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se cilat janë organet e Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe Këshillin. Në këtë pikëpamje patjetër kjo procedurë nuk duhet të fillonte me ju si Komisioni i Ekonomisë, por duhej patjetër që kërkesa t'i paraqitej kryetarit dhe të kalonte në Komisionin e Ligjeve. Për më tepër që në dallim nga rasti analog për sa u përket shkarkimit të institucioneve që parashikohen me ligj, në rastin konkret përcaktohet që kërkesa duhet të jetë e motivuar dhe konkrete. Në rastin konkret, të paktën juve këtu si institucion, pasi kjo nuk është thjesht një mbledhje e zakonshme e këtij komisioni, por është një mbledhje, e cila në njëfarë mënyre përpiqet që të zhvillojë një lloj hetimi, me të anë të të cilit ju do të bindni veten, pastaj edhe Kuvendin për qëndrueshmërinë bazuar në ligj të kërkesës që është bërë. Nga kjo pikëpamje edhe garantimi i të drejtës për proces të rregullt në këtë seancë është një kërkesë e domosdoshme aq më pak që lidhet me pasojat të drejtpërdrejta të anëtarit në fjalë. Nëse ju i referoheni materialit, faktikisht është kopje, aty përdoren disa nocione, të cilat në vetvete vetë nocionet bien ndesh me atë çfarë pretendojnë propozuesit. Konkretisht aty përmendet analogjia, analogjia është lejuar për t'u zbatuar vetëm në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, por në republikën demokratike, në të cilën jetojmë e ndalon, parimet themelore kushtetuese e ndalojnë zbatimin e ligjit me analogji, edhe pse aty është parashikuar në materialin që ju është dhënë juve.

Së dyti, fjala “diskrecion” është parë fare qartë, sepse Këshilli Mbikëqyrës është ai që duhet të propozonte praktikisht shkarkimin. Kjo nuk është bërë kot, por është bërë pikërisht për të siguruar pavarësinë kushtetuese të Bankës së Shqipërisë. Loja me Bankën e Shqipërisë, të nderuar deputetë, sepse unë jam edhe qytetar njëkohësisht është lojë shumë e rrezikshme dhe nëse banka cenohet, dijeni se ne të gjithë do të jemi në një piramidë të dytës, siç ishte ajo e vitit 1997.

Për sa i përket “diskrecionit”, përsëri kemi një kakofoni juridike të çuditshme, sepse vetë fjala “diskrecion” do të thotë pushtet i fshehur apo pushtet, i cili buron vetvetiu nga funksioni i një organi, por me kusht që të mos e ketë një organ tjetër. Në rastin konkret na

dalën dy organe diskrecionale, edhe Kuvendi, 28 deputetët, edhe Këshilli i Ministrave. Tani, vetë fjala “diskrecion”, nuk mund të kemi diskrecion dy herë me dy njerëz.

Nga ana tjetër nuk plotëson kriteret, sepse që pushteti të jetë diskrecionar duhet që të mos ta ketë dikush tjetër, ndërkohë që ligji ia ka dhënë shprehimisht Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Pjesa tjetër ajo që duhet të keni parasysh ju në këtë procedurë pavarësisht se gjykoj që për kompetencë nuk duhet të ishit ju për ta shqyrtuar fillimisht, ka të bëjë me administrimin e provave. Praktikisht ju po shqyrtoni një akuzë dhe po i propozoni Kuvendit një arsyetim akuze dhe si çdo akuzë, do të duhet që ajo në radhë të parë të jetë konkrete, nuk mund të jetë me fjalë të përgjithshme, sado poetike që mund të jenë.

Së dyti, duhet të bazohet në fakte dhe prova konkrete. Unë kam bërë një kërkesë, kam kërkuar nëse ka prova dhe dokumentacione që mbështesin pretendimin. Ajo që më është dhënë nuk ka asnjë. Nëse ju keni, do t’ju ftoja që t’i ndanit me ne, por gjykoj se proceduralisht ju nuk mund të vazhdoni gjykimin e një të akuzuari që ta akuzoni, por nuk keni marrë asnjë provë.

Nga ana tjetër nuk kërkon prova. I bie që pastaj kjo nuk është seancë dëgjimore, por është gjyq inkuizicional dhe nuk do të ishte në nderin tuaj si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë ta bënit një gjë të tillë.

Gjykoj se në rastin konkret, ju po gjykoni edhe për sa i përket ekuilibrit apo asaj që njihet midis lirisë së shprehjes dhe nevojës për të mbrojtur institucionin e BSH-së. Sigurisht që liria e shprehjes është baza e një shoqërie demokratike dhe nuk duhet absolutisht të abuzohet, por të respektohet dhe të mbrohet. Në rastin konkret, të paktën në asnjë material që kemi, nuk ekziston kjo gjë, gjithsesi ne do t’i kërkojmë këtij komisioni që, nëse do ta gjykojë me vend në vazhdimësi, të mos e përfundojë sot, me qëllim që të administrojmë edhe disa kërkesa që kemi bërë. Do t’ju paraqesim më shkrim edhe disa arsye të tjera.

Megjithatë, kjo mbetet në vlerësimin tuaj!

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, patjetër.

Arben Malaj – Faleminderit!

Ndoshta ju më mirë se kushdo tjetër duhet ta sqaroni këtë gjë, sepse në bazë të Rregullores, kur ngrihet një çështje nga deputetët për shkarkimin e një anëtar të institucioneve kushtetuese, procesi është shumë burokratik, por nga ajo që kam konstatuar dhe mbështes edhe

atë që tha avokati, ka shumë pika të errëta në mënyrën se si po operoni. Unë i kam kërkuar Kuvendit, qeverisë dhe Këshillit Mbikëqyrës që procesi të përfundonte sa më shpejt, nëse ju do të ishit realisht të shqetësuar se po tronditej rëndë (sipas asaj që shkruani) kredibiliteti i BSH-së. Në raste të tilla, në vende të tjera, çështja mbyllet brenda 3 ditësh, kurse në disa raste, me vjen keq që po e përmend Dominique Strauss-Kahn, gjëja zgjidhet me mirëkuptim, me dorëheqje, sepse po të pritej gjyqi deri sa të shpallej i dënuar do të duhej një kohë e gjatë dhe menaxhimi i atij institucioni do të pengohej.

Në programin e punës së Kuvendit për periudhën 2 shtator -18 tetor 2019 te pika 34 është përcaktuar projektvendimi, pra iniciativa e deputetëve për shkarkimin tim dhe thuhet “Nismëtarët, grupi i deputetëve, komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat”. Sipas Rregullores, për shkarkimin e anëtarëve të institucioneve kushtetuese, koha që ju duhet të keni në dispozicion është jo më shumë se 4 javë. Po kështu, në programin e punës 21 tetor – 13 dhjetor 2019, pika 25 është projektvendimi për t’u shqyrtuar për shkarkimin dhe aty thuhet “Komisioni për Ekonominë dhe Financat”.

Çuditërisht, në faqen zyrtare të Kuvendit, kur e rishikon programin, vihet re që kjo pikë nuk është më. A mundet, i nderuar kryetar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë, që është komisioni përgjegjës për pavarësinë reale të BSH-së, të më qartësoni përse nuk është vepruar, nga program nuk ka kaluar në kalendar? A ka një vendim të komisionit tuaj me shkrim të paraqitur para Kryetarit të Kuvendit, të miratuar në Konferencën e Kryetarëve dhe a është njoftuar seanca që është hequr kjo pikë nga programi?

Unë do të doja një përgjigje me shkrim nga ju, sepse është një pjesë e rëndësishme e ballafaqimit, jo vetëm publik, por edhe ligjor!

Pra më 15 korrik bënë kërkesë 28 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Mezi e futët në programin e punës së Kuvendit më 2 shtator dhe nuk keni asnjë hap konkret përveç se kur në 3 dhjetor Kryeministri u zgjua dhe kërkoi që me ferman sulltanor të merrte një vendim për pezullimin dhe shkarkimin tim.

Cilat janë arsyet e kësaj shkeljeje dhe a ka ndonjë falsifikim në dokumentin zyrtar të Kuvendit, institucioni, i cili duhet të ruajë besueshmërinë maksimale, pasi është një nga kolonat ku mbështetet demokracia e një vendi? E ka pasur dy herë në program, e ka hequr me të njëjtën datë programi dhe ju, si Komision i Ekonomisë keni shkelur detyrimin e Rregullores që ta shqyrtonit brenda 4 javëve.

Këto janë të gjitha prova materiale dhe lehtësisht të verifikueshme edhe nga ju.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Malaj!

Po, zonja Edlira.

Arben Malaj – Jo, ju lutem, ju jeni i detyruar të përgjigjeni pasi unë reagoj, bëj një pyetje të drejtpërdrejtë dhe ligjore, se nuk bëra deklarata partiake, u bazova në Kushtetutën e vendit tim, në ligjin e BSH-së, në Rregulloren e Kuvendit, ju vërtetova me dokument se mund të ketë tendenca falsifikuese në dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë, kurse ju ia kaloni fjalën një tjetri.

Ju duhet të thoni po ose jo, ose t'i kërkonti stafit tuaj të verifikojë, t'ju informojë, se nuk është punë që e bëni ju, të raportojë tek avokati im dhe t'i jepni kopjen e procedurave, që do t'ju sqarojë stafi juridik i komisionit tuaj ose i parlamentit.

Arben Ahmetaj – Zoti Malaj, unë e di se çfarë them dhe çfarë bëj dhe ma lejon procedura të bëj atë që bëj. Do t'ju kthej përgjigje për atë që kam tagër në momentin kur të kenë mbaruar komentet e deputetëve.

Do t'ju lutesha që të mos e ndërpresim njëri-tjetrin, që ju të thoni ato që doni të thoni dhe unë të vazhdoj procedurën, që nuk është aspak e lehtë për mua.

Po, zonja Edlira.

Edlira Hyseni– Përshëndetje!

Profesor Malaj, është kënaqësi t'ju dëgjojmë këtu! Unë jam një ndjekëse e juaja qoftë në media, qoftë në rrjetet sociale. E konsideroj privilegj dhe fat për këtë vend të ketë profesionistë si ju. Unë jam vetë me profesion financiare, audituese e pavarur, por ju jeni një aset për këtë vend dhe pa dyshim për BSH-në. Sinqerisht më duket një nga mbledhjet më të tensionuara dhe më pak të rehatshme që kemi bërë këto muaj. Ne jemi opozitë e re, pra nuk kemi eksperiencë afatgjatë dhe nuk do të doja të ishim akuzues apo palë që po bëjmë një gjyq, sepse nuk besoj se jemi në gjyq këtu, por jemi në një komision ku duhet të votojmë nëse kemi një bindje për kërkesat e parashtruara për shkarkimin apo jo të zotit Malaj. Të paktën deri në këto momente jemi duke folur ne, pala e opozitës, kur faktikisht nuk kemi bërë akuza, madje jemi përpjekur të mbrojmë dhe të kuptojmë pse kemi arritur në këtë pozicion. Mua, edhe pse ju kërkonti ta përjashtoni anën politike, më duket e vështirë, sepse duket që kjo është një luftë, apo një betejë politike, në të cilën unë nuk mund të hyj, nuk ka rëndësi krahu i majtë apo i djathtë, se kohët ndryshojnë, ka rotacion, pra mund të ndodhë në çdo kohë, nuk ka rëndësi nëse sot e bën e majta, sepse nesër e

bën e djathta, por unë nuk jam për të tilla beteja politike dhe sinqerisht më duket sikur ju jeni kurban i parë i filozofisë dhe i frymës së paketës së famshme antishpifje, sepse edhe me këtë paketë, do të jetë e vështirë të ndahet shprehja e lirë nga shpifja. Ju keni mbajtur qëndrimet tuaja brenda profesionit të nderuar, por ajo që më bën përshtypje në relacion është se kemi shumë pak argumentim për shkarkimin tuaj, pasi ky relacion përsërit pak a shumë të njëjtat fjalë, se kur relacionet janë të gjata dhe përsërisin fjalët, tregon se mungon thelbi, nuk ka ndonjë argument të madh.

Dy gjëra do të doja të vija në fokus.

E para, vetë Kuvendi më 8 maj 2019 i kërkon Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së nëpërmjet një rezolute të shprehet, apo të marrë në shqyrtim zbatimin, apo jo të Kodit të Etikës nga ju personalisht, apo nga anëtarë të tjerë të Këshillit. Në fakt, në dy muaj, vetë relacioni na thotë që BSH-ja apo Këshilli Mbikëqyrës i BSH-së nuk ka depozituar një raport, apo një relacion, që të japë konkluzionet e veta në lidhje me sjelljen tuaj etike apo joetike. Pra, institucioni për të cilin ju akuzoheni se mund të keni penalizuar emrin e mirë, imazhin, reputacionin, apo dëme të tjera, nuk është shprehur. Ne nuk kemi një raport që të jetë shprehur në lidhje me dëmin që mund t'i keni sjellë me veprimet apo mosveprimet tuaja dhe kjo më bën të ngre pyetjen: BSH-ja është pro apo kundër shkarkimit tuaj? Ju sheh si element të dëmshëm, apo ndihmës në punën e saj. Pra, mospërgjigjja nga BSH-ja tregon që Banka nuk është pro shkarkimit tuaj?

E dyta, në relacion na thuhet që e vetmja liri e lejuar për anëtarin e Këshillit është liria akademike. Kjo “e vetmja liri e lejuar” me duket e frikshme. Shpresoj të keni liri të tjera, sepse nëse e vetmja liri e lejuar është liria akademike, më duket shumë pak, por gjithsesi brenda lirisë së lejuar, pra ajo akademike, ju mund të shprehni qëndrimet tuaja personale e profesionale, duke bërë të qartë që nuk përfaqësoni qëndrimin zyrtar të institucionit nga vini. A mund të themi që në të gjitha opinionet që keni shprehur në medie të shkruar, audiovizive, apo në faqen tuaj të *facebook*-ut, ku bëni gabime ortografike, edhe kur ato janë kundër politikave qeverisëse, është e drejta juaj për t'i shprehur këto opinione të pavarura dhe të lira në kuadër të lirisë akademike që keni? A mund të përmbliidhen të gjitha dëmet, që mund të keni bërë me fjalën tuaj të lirë, në lirinë tuaj akademike? Unë shpresoj që kjo procedurë të mos shkojë përpara dhe ju të mos shkarkoheni, pasi jeni aset i çmuar i këtij vendi!

Ju faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Malaj.

Arben Malaj – Unë e falënderoj kolegen deputete!

Edhe një herë ju kërkoj mirëkuptim. Unë kam 16 vjet përvojë parlamentare dhe përgjegjësi qeverisjeje, kurrë nuk do ta përdor komisionin parlamentar të vendit tim për debate partiake dhe kjo hyn vetëm te pjesa strikt ligjore. Atë ia kam premtuar si dhuratë Kryeministrit për Vitin e Ri ditën që ju do të votoni para se të mbyllet seanca, sepse të gjithë rrugëtimin tim politik nuk mund ta lë ta keqpërdorë as Rama e askush tjetër.

Lidhur me Këshillin, por të kishte ndonjë shqetësim, do të ishte shprehur, por fakti që nuk është shprehur do të thotë se nuk ka shqetësim, madje unë do t'ju jap kopjen e noterizuar të procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, e cila e shqyrtoi këtë gjë vetëm pasi këmbëngula unë, sepse nuk kishte kuptim që 28 deputetë të këtij Kuvendi, pavarësisht se i kishin akuzat shpifëse, të mos vlerësoheshin si një element që bordi duhej të diskutonte. I kam bërë kërkesë me shkrim edhe qeverisë, që ditën që do të merrte vendimin, të më krijonte mundësinë t'i dëgjoja dhe të mbrohesha.

Ata vendosin vetë, unë nuk kam fuqi të ndryshoj vendimet e tyre. Në këtë aspekt, me Këshillin Mbikëqyrës të BSH-së, ata nuk janë shprehur asnjëherë, madje në 7 gusht 2019 më kanë rikonfirmuar vlerën e shtuar për vendin dhe Bankën Qendrore, ju përdorët fjalën “aset”, por ne ekonomistët për asetet kemi frikë nga amortizimi.

Për sa i përket analizave dhe akuzave kryesore, se e thashë që me këtë do të merrem, më lejoni të lexoj disa tituj prononcimesh në gazeta, në *facebook*, që në thelb janë përkushtimi im për sfidat që ka pasur ekonomia e vendit tim.

Dhjetor 2018 (nuk po i them gradat shkencore) Arben Malaj. “Banka Qendrore dhe risku i reputacionit publik” bazuar në atë libër, që duhet të jetë bibla e bankierëve të bankave qendrore.

4 shkurt 2019, retë e krizës italiane për ekonominë shqiptare”, për të kuptuar që duhet të përgatiteshim nga goditjet asimetrike, që mund t'i vijnë ekonomisë sonë, kur partnerët kryesorë tregtarë mund të hyjnë në kohë krize.

22 prill 2019, “Që ngërçi politik të mos ushqejë një krizë të re, që nesër ë mos jemi përsëri shumë vonë”, apel ky që palët të marrin përgjegjësi për zhvillimin e vendit, sepse kostot politike janë ekonomike, sociale dhe varfërojnë gjithnjë e më shumë vendet.

Kam studiuar një vit në universitetin Havardit për integrimin europian të Ballkanit Perëndimor. Jam lektor në master profesional dhe shkencor për integrimin e BE-së. Shkrimi im,

pas dështimesh të përsëritura të vendit tim, që nuk janë vetëm të kësaj maxhorance, është 9 maj 2019 “Shqipëria, sërish zhgënjyese”. 9 maj 1950 “Europa e Bashkuar, thellësisht frymëzuese”.

Arben Malaj, 27 maj 2019 “BE-ja përballë populistëve dhe euroskeptikëve”, është një risk potencial gjithnjë në rritje që mund të prekë edhe vendin tonë dhe si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së unë kam informacione dhe nga analizat kuptoj se sa kosto mund të sjellë mungesa e paqes dhe prosperitetit përballë populistëve dhe euroskeptikëve.

Shkrim më 7 gusht 2019, Arben Malaj, “Mbrotjtja e qytetarëve nga tendencat abuzive të bankave”. Sot bëhet debati që bankat janë institucione, por bankierët abuzojnë me kredidhënien, pra në vend që të japin kredi shesin kredi. Në vendet e tjera penalizohen me burg. Po të flasim për bankat dhe për bankierët dhe po të mos vëmë gishtin te plaga, domethënë te kreditë e këqija që shkuan në 50% në sektorin e ndërtimit, është një kosto që e paguajnë taksapaguesit shqiptarë. Unë kam pasur guximin si profesor dhe si analist, jo si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, të kërkoj që të përmirësohen të gjitha manualët.

20 nëntor 2019, Arben Malaj, “Buxheti të bëjë transparencë çdo qindarkë!”. Të kërkosht transparencë për paratë e taksapaguesve shqiptarë besoj se i bën mirë Shqipërisë, madje cilësia e menaxhimit të buxhetit kushtëzon cilësinë dhe efikasitetin e politikave monetare.

Kështu që, lidhur me atë që thatë, besoj se gjerat janë të qarta, angazhimi dhe përkushtimi im është i përhershëm dhe profesional. Të falënderoj shumë për atë vërejtje që e kam defekt dhe shpresoj se do të zgjidhet sa më shpejt.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Malaj!

A ka ndonjë koment tjetër nga deputetët? Nuk ka.

E keni për pyetje?

Po, urdhëroni!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, tani u njoha me raportin, si anëtar zëvendësues i këtij komisioni dhe po më duket njëlloj si gjyqi i Kadri Hazbiut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, por duhet ta dijë familja, se koha kur dënoheshin njerëzit në sallën e Komitetit Qendror ka shkuar në PS, ka gati 30 vjet. Nuk e kam me ju, por i referohem komisionit që po

mban të njëjtin qëndrim në heshtje. Në 29 vjet postkomunizëm është hera e parë që bëhet një gjyq publik pse dikush i zgjedhur nga Kuvendi paska prishur rehatin e maxhorancës.

Zoti kryetar i Komisionit të Ekonomisë, a e keni parë listën prej 125 vetash që janë votuar nga ky Kuvend dhe kanë rrogat me të larta se deputetët, të cilët nuk lënë kënd pa sharë nëpër studiot televizive sa ju as ne dhe marrin nëpër gojë kë t'u teket? I keni të emëruar nga ky Kuvend dhe nuk bilbilosni asnjë gjysmë fjalë se janë bërë synet nga gjuha, se ju kanë dhënë urdhër të mos flisni. A e keni kryetarin e KRTRSH-se Rakipllarin studio më studio, që degjeneron kë t'i vijë për mbarë dhe bën politikë? Cili është ai komision që bën monitorimin e këtyre që janë zgjedhur nga Kuvendi, që shajnë partinë? A e kishit këtu Gjekë Markaj, që paguhet nga taksapaguesit shqiptarë? Pse qeshni? Flisni! Ju degjeneroi dhe ju tha që nuk jeni as deputetë.

Arben Ahmetaj – Zoti Murrizi, vazhdoni me logjikën tuaj!

Myslim Murrizi – Mos ma prit fjalën!

A ishin këtu ata para dy ditësh dhe nuk lanë deputetët të këtij Kuvendi pa ofenduar dhe ju nuk i thatë asnjë gjysmë fjalë, se shefi juaj thotë “Kur ju lehin qentë, po flasin analistët”, për lehjen dhe që nuk lënë njeri pa marrë nëpër gojë, institucion pa degjeneruar? Ju prej 6 vitesh në maxhorancë heshtni. Çfarë është ky qëndrim me dy standarde?

Zoti Malaj, që keni marrë përsipër ta bëni shembull, paska ceduar se Kuvendi në dhjetor 2018 paska miratuar një Rregullore që këta që zgjidhen nga Kuvendi nuk duhet të bëjnë më *cëq* në *facebook*, apo të flasin gjëkund, por vetëm sipas oreksit të maxhorancës, e shumë e shumë të tjerë, por nuk po i përmend, se e kam listën këtu. Shqiptarët nuk e dinë që ata paguhën nga 1 milion e gjysmë deri në 2 milionë lekë në muaj, janë votuar nga ky Kuvend dhe degjenerojnë kë t'u dalë përpara, vijnë e ju bëjnë karshillëk këtu, kurse ju heshtni. Nëse doni vërtet të jeni të paanshëm dhe paskeni qejf ta filloni nga zoti Malaj, meqë është i partisë tuaj, bëni një listë për të gjithë dhe mos e bëni paçavure, mos u bëni qesharakë! Ju nga një anë thoni se po shembni 10 pallate në ditë dhe kanë mbetur 20 mijë qytetarë shqiptarë pa banesë, nga ana tjetër, keni kohën, luksin, dhe nge të merreni, se je emëruar edhe ministër i tërmetit ti, me gjyqe false politike të atyre që...

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Çfarë po thua Evis?! Pse nuk emërua Damiani, po thua ti?!

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Për tërmetin po them edhe unë. Ti kishe dëshirë që ai të ishte ministri i tërmetit prej vërteti, por është më mirë që është ky.

Nëse doni që të mos bëjmë oponencë, sikur ju po e vrisni dhe ne po e mbrojmë nenin, merrini dhe sillini këtu të gjithë ata që paguhen nga taksapaguesit shqiptarë për të bërë atë detyrë që ua ka ngarkuar Kuvendi dhe të mos flasin shumë për kë u mbushet mendja atyre, duke i përdorur ekranet televiziveve si “12.7-she” të ‘97-ës. Le t’i listojë të gjithë këta ai Komisioni juaj i famshëm i Monitorimit, nëse keni këllqe. Po nuk ju shërbyen me orekse paradite, ju shërbejnë me meze pasdite dhe me meze të tjera. Hajdeni të mbajmë një qëndrim për të gjithë këta dhe kjo do të na shërbejë si mësim, ndoshta edhe për zotin Malaj, si dhe për të gjithë ata që flasin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni shumë.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Malaj , unë nuk e kam fare me ju, por dua të jem i sinqertë ...

Arben Ahmetaj – Zoti Murrizi, ju kërkoj ndjesë!

Ju lutem, mos bëni debat me zotin Malaj.

Myslim Murrizi - Të jemi i sinqertë njeriu që shikoj më pak në medie, nga 125 veta që janë zgjedhur nga Kuvendi dhe paguhen nga taksapaguesit shqiptarë, të cilët përbaltin çdolloj institucioni dhe që bëjnë politikë nga mëngjesi deri në darkë, jeni ju. Unë nuk ju kam parë gjëkund ju, por ka disa të tjerë që japim lajme çdo ditë, madje kanë zëvendësuar Petrit Lekën që jepte kohën me shkop në dorë. Ke frikë të nderësh televizorin se fytyrat, të cilët janë zgjedhur nga Kuvendi dhe që paguhen nga taksapaguesit shqiptarë, behën rezil gjithandej. E çon televizorin te “Top Channel”, del surrati i njërit, e çon te “Klani” del surrati i tjetrit, e çon e “News 24” del surrati i tjetrit, surrati e njërit e shikon tek teatri, tek unaza shikon surrati e tjetrit, kurse ju nuk guxoni të flisni. Pse nuk flisni?! Kush ju ka kapur prej fyti?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dy herë jua thashë: unë e kam këtu listën me 125 veta. I thoni atij organizmit që i mbikëqyr këta dhe bëni një listë që t’i disiplinojnë të gjithë ata, që janë zgjedhur nga Kuvendi dhe paguhen nga taksapaguesit shqiptarë, në mënyrë që gjithsecili të bëjë punë e tij. Të gjithë dinë të bëjnë politikë, por ju keni detyra më të mëdha si kryetar i Komisionit të Ekonomisë, jo si Arben. A e dini se ka 13 muaj që ka mbaruar mandati i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit? Ne ende nuk kemi kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kurse ju thoni se do ta hiqni

Arbenin si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Kanë kaluar 13 muaj në këtë vend qesharak. Pse nuk e zëvendësoni?! Sepse nuk bini dakord për atë që do vijë t'ju ngrohë petullat. Ju ka sjellë 3 kandidatë ai shoku juaj apo shyqyr tani që ra tërmeti dhe u pajtuat ju! Gjejini, pra, emrin dhe zëvendësojeni! Kështu, unë shikoj një falsitet, një ngutje, një nxitim, një grykësi për të tulatur çdo të ri që ka mendjen jashtë karriges, për të cilën paguhet dhe shikoj një qëndrim me dyfytërsi, me dy standarde. Unë ju shikoj ju pa kurajë për të mbajtur një qëndrim për të gjithë ata që nuk lënë gjë pa thënë për ju dhe për këdo që ata gjykojnë se u prish atyre terezinë, edhe pse paguhet rreth 2 milionë lekë në muaj të legalizuara, pra me dyfishin e pagës që marrin deputetët, se nuk e dimë sa marrin për honorarët nga taksapaguesit shqiptarë. Nëse doni të bëni standard, meqenëse jeni një komision që po gjykon një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe nëse keni dëshirë që para atyre që na ndjekin, atyre që na kanë votuar politikisht, se individualisht asnjëri nga ne nuk është votuar (se me tri palë zgjedhje nuk ka më deputetë, ka punëtorë të partisë së Kuvendit të Shqipërisë), merreni atë listë dhe fillojeni nga ata që realisht vetëm me punën që u ka caktuar Kuvendi nuk merren, por bëjnë politikë gjithë ditën dhe shajnë kë t'u vijë për mbarë! Merruni njëherë me ata, më pas, nuk dihet, nëse u vjen radha të merreni me zotin Malaj!

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Murrizi!

Unë mendoj se propozimi i zotit Murrizi duhet të regjistrohet nga shërbimet e Kuvendit që të fillojë, në bazë të procedurës ligjore, ku ka individë të emëruar në institucione të ndryshme dhe të pavarura të bëhet i njëjti skanim, në referencë të ligjeve dhe Kodit Etik në tërësi. Dua të bëj një sqarim, meqenëse ma kërkoi zoti Malaj. Besoj se këtë gjë e kam bërë një herë të qartë, por tani do ta sqaroj zyrtarisht: në dijeninë time, futet në program një procedurë në pritje të ardhjes së dokumentit ose të ligjit. Në rastin konkret dokumenti nuk ka ardhur ende nga Këshilli i Ministrave, kështu që shërbimet e Kuvendit nuk mund të fusin në kalendar, aq më tepër unë, sepse nuk e kam atë të drejtë ta fus në kalendar, një procedurë, e cila nuk ka ndjekur ende rrugën e saj normale. Pra, në qoftë se do t'i referohemi ligjit të Bankës së Shqipërisë, në nenin 47, pika 1, thuhet: “Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë Guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët pezullohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave dhe shkarkohet nga Kuvendi, në qoftë se ai ose ajo...” dhe vazhdon më tej. Pra, këtu thuhet “pezullohen nga detyra”. Unë apo komisioni që drejtoj, në referencë edhe Kuvendi, nuk mund të zhvillonim një proces për

asgjë, sepse fillimisht do të duhej të prononcohej zyrtarisht Këshilli i Ministrave, ashtu siç është prononcuar me vendimin nr. 766 dhe në relacionin e këtij vendimi është e gjithë materia, së cilës iu referua edhe avokati. Pra, janë dy dokumente që besoj se ju janë vënë në dispozicion, pra vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 766 dhe iniciativa e 28 deputetëve. Për procedurë mua më takon që ta hedh në votim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, zoti Avokat, vetëm zoti Malaj ka të drejtën e fjalës.

Po, zoti Malaj.

Arben Malaj – Së pari, zoti Ahmetaj, dua të bëj një sqarim.

Bazuar në eksperiencën e gjatë me shkresa, ju keni një tendencë për ta anashkuar problemin, por ai është lehtësisht i verifikueshëm. Kërkesa e 28 deputetëve është bërë në datën 15 korrik në parlament. Kopjen e shkresës për herë të parë ma ka dhënë sekretari i Përgjithshëm, ku pretendohej se Kuvendi ia ka nisur qeverisë shkresën në datën 16 korrik. Ju e keni përfshirë në program në datën 2 shtator dhe e keni ripërsëritur deri më 13 dhjetor, por më pas e keni hequr nga kopja aktuale e programit. Për fat të mirë, Kuvendi i Shqipërisë ka transparencë maksimale për dokumentet e tij dhe kjo ma lehtëson mua të drejtën, çka do të thotë se edhe vendosja, edhe tërheqja merren me vendim në seancë dhe njoftimi, kur diçka përfshihet në program dhe më pas kalohet në kalendar, nuk është një procedurë telefonash, por është një procedurë strikte burokratike.

Së dyti, unë besoj se është në të drejtën time që kur duhet një argument më i thelluar juridik, ju të mos ia ndërprisni të drejtën e fjalës avokatit, prandaj unë sot kam ardhur me avokat dhe për këtë ju kam lajmëruar. Kështu, ju lutem shumë, le të shprehet njëherë avokati im dhe më pas vendimet merrini si të doni ju. Kjo është një e drejtë ligjore, është një e drejtë njerëzore, është e drejta e njeriut që, kur një njeri kërkon të mbrohet me avokat, nuk ka gjykatës në botë, jo më një kryetar i një komisioni parlamentar, t'i thotë personit që mund të flasësh ti, por avokati juaj nuk do të flasë. Ndaj, ju lutem shumë, unë e di që ju jeni i mbingarkuar, por nuk duhet të shkëlmi parimet bazë dhe të drejtat themelore të njeriut, sepse e drejta për t'u mbrojtur me një avokat është e drejtë e pacenueshme dhe e patjetërsueshme.

Arben Ahmetaj – Zoti Malaj, unë nuk jam aspak i mbingarkuar, përkundrazi, po mundohem të ndjek procedurën siç e thotë ligji. Ligji nuk e përmend avokatin, megjithatë me kërkesën tuaj ne e pranuan avokatin në komision. Fjalën këtu e jap unë dhe unë nuk ia jap fjalën

avokatit, por jua jap juve sa herë të doni dhe si të doni, madje mund të më ndërprisni 100 herë nëse doni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër!

E theksoj: ju mund të flisni sa herë të doni! Edhe një herë: unë nuk e detyroj qeverinë se kur duhet të kthejë përgjigje, sepse qeveria ka kthyer përgjigje me atë vendim për të cilin ju jeni vënë në dijeni dhe e keni në dispozicion. Në bazë të ligjit, në dijeninë time, është bërë edhe njoftimi për fjalën tuaj në seancë. Unë kam detyrimin procedural, që propozimin e zotit Lita për ndërprerjen ose vazhdimin e kësaj seance ta hedh në votim. Për rekordet zyrtare dua të theksoj se zoti Murrizi dhe zoti Çaçani nuk janë deputetë me të drejtë vote në këtë komision, pra ata nuk votojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë thjesht po bëj procedurën, zoti Murrizi, kështu që me kërkesë të zotit Korab Lita unë po e hedh në...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ju lutem!

Arben Malaj – Duhet të dokumentohet kërkesa, e cila është tërësisht ligjore që, në rastin kur shqyrtohet një iniciativë ligjore, propozuesit duhet të jenë në mbledhjen e komisionit për t’iu përgjigjur pyetjeve të personit ndaj të cilit ka dalë akti ligjor. Kështu që kjo duhet të dokumentohet si kërkesë.

Së dyti, mendoj dhe vlerësoj se vazhdimi i mbledhjes dhe hedhja në votë nuk mund të bëhet pa na garantuar ju, si kryetar i këtij komisioni të Kuvendit, që keni detyrimin kushtetues të mbroni pavarësinë reale të Bankës së Shqipërisë, dokumentacionin bazik të qeverisë. Mbledhja mund të shtyhet në një kohë të dytë, qoftë edhe pasdite, kur t’i bëjë gati qeveria dokumentet, sepse ne gati jemi, por nuk mund të merret një vendim në mungesë të dokumentacionit të plotë ku gjenden argumentet dhe diskutimet. Një shprehje është: “Djalli qëndron në detaje”, ndaj në rastin e ballafaqimeve gjyqësore detajet janë më të rëndësishme sesa parullat.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Malaj!

Unë i referohem procedurës ligjore dhe vendimit nr. 766 të Këshillit të Ministrave që e ka përcjellë në Kuvend. Ligji nuk flet as për procesverbale, as për video, pasi ato mund t’ju duhen juve apo avokatit tuaj në një proces ndoshta siç ju iu referuat, sepse, mbi të gjitha, kjo nuk është

një nismë ligjore, por është një iniciativë nga deputetët. Unë e kam për detyrë që propozimin e zotit Lita ta hedh në votim në referencë të asaj që ai kërkoi. Më pas me vota, nëse do të pezullohet, është një vendim që i takon komisionit. Kështu që më lejoni që unë të bëj procedurën ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti Malaj !

Atëherë, kush është dakord për shtyrjen e seancës dëgjimore me zotin Malaj? Kundër?

Propozimi i zotit Lita për shtyrjen e seancës rrëzohet.

Në këto kushte, në bazë të numrit të votave, unë jam i detyruar të vazhdoj me procedurën.

(Diskutime pa mikrofon)

Besoj se sekretaria i ka numëruar votat dhe janë 6 vota pro dhe 12 vota kundër.

Zoti Malaj, mund t'ju vihet në dispozicion edhe procesverbali i mbledhjes i detajuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Lita, ju kërkoj ndjesë, por kam nevojë për qetësi!

Ju lutem, zonja Edlira!

Atëherë, vazhdojmë mbledhjen. Kush ka pyetje apo komente të tjera lidhur me procesin apo për zotin Malaj?

Po, zonja Suzana.

Suzana Topi – Siç u pa, Këshilli i Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka refuzuar të shqyrtojë dhe të reagojë ndaj sjelljes së zotit Malaj, sepse nuk shikon shkelje të Kodit të Etikës dhe të rregullave të sjelljes, të miratuara nga vetë Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në vitin 2003. Ky është një refuzim i hapur ndaj politikave të qeverisë se kushdo që është kundër saj duhet të shkarkohet, të futet në burg dhe të penalizohet për të vetmen arsye se nuk i shërben partisë-shtet. Demokracia në këtë vend po atrofizohet dhe maxhoranca gjithëpërfshirëse me forcën e kartonit po mundohet të shkarkojë një person, i cili është një aset i vyer në Bankën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminerti!

A ka ndonjë koment tjetër? Nuk ka.

Zoti Malaj, a keni ndonjë gjë për të thënë, para se ta mbyll procesin?

Arben Malaj – Së pari, avokati im ka një pyetje, të cilën e bën nëpërmjet meje, meqenëse ju e penguat ta bëjë dhe që mendoj se duhet të protokollohet. Cilat janë provat që keni administruar, përveç shkresës së ardhur, për të bërë këtë gjykim për një anëtar të institucionit kushtetues?

Së dyti, dëshiroj të falënderoj nga zemra solidaritetin socialist. Unë i shikoj në sy të gjithë deputetët socialistë dhe më vjen keq që nuk kanë kurajë të bëjnë pyetje ose të thjesht të flasin, të thonë çfarë ata dëshirojnë, por gjysma rrinë kokulur dhe gjysma tjetër shikojnë sms-të. Ky nuk është gjyqi im, ky është gjyqi juaj. Ky është gjyqi i qeverisë që kërkon të marrë të gjitha pushtetet; ky është gjyqi i atyre që duan të shtrijnë duart në të gjitha institucionet kushtetuese të vendit. Kjo është krenaria ime përballë jush, sepse i kam shërbyer vendit tim dhe do t'i shërbej gjithë jetën me dashuri maksimale, me përkushtim maksimal, me mendje dhe jo me ato që ju meritoni, të cilat nuk po jua them këtu, por do t'jua them në seancë. Ju meritoni që këtu t'ju sillja grupin e Vlorës që t'ju këndonte poezinë e Ali Asllanit, por nuk do ta bëj këtu, por do ta bëj në seancë.

Faleminderit dhe nuk jam i zhgënjyer nga asnjë prej jush, as nga zoti Ahmetaj, për të cilin kam investuar shumë, që një ditë ai të ishte i dobishëm për vendin e tij, por, me sa duket, ai është pjesë e së njëjtës strategji.

Faleminderit shumë!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Malaj!

Investimin ia kemi kthyer vendit, siç thatë edhe ju, por debati nuk është midis meje dhe teje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ekzakt!

Edhe unë kam investuar te ju dhe besoj se kemi mësuar nga njëri-tjetri, por nuk është ky diskutimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit, zoti Malaj!

A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Unë e konsideroj të mbyllur dëgjuesën me zotin Malaj dhe kalojmë në procedurën e votimit!

(Diskutime pa mikrofon)

Medie, pasi të mbarojmë me procedurën e votimit do t'ju lutesha të prisnit se kemi dekretin e Presidentit.

Në rregull!

(Diskutime pa mikrofon)

Unë po ju them të dilni dhe të prisni jashtë! Unë po bëj njoftim zyrtar.

Kërkoj audio për këtë diskutim, sepse duhet të regjistrohet për Kuvendin.

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, se nuk ju dëgjova!

Do të bëjmë një diskutim dhe pastaj do t'ju ftojme.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit për pyetjet që i bëtë zotit Malaj, për komentet që bëtë në diskrecion në vlerësimin tuaj për zotin Malaj!

Unë mendoj se pas votimit që bëmë për propozimin e zotit Lita procesi do të mbarojë sot. Besoj se duhet të kalojmë në votim, për ta kaluar më pas në seancë dhe pastaj të ftojme median për t'i dhënë rezultatin.

A është dakord edhe opozita me këtë?

Zoti Roshi, si thoni?

Artur Roshi – Kryetar, në qoftë se zoti Malaj kishte një lloj pretendimi për ardhjen e asaj shkrese dhe shkresa mund të vijë...

Person f – Argumentet.

Artur Roshi – Jo, shkresa.

Nuk na kushton gjë ta shtyjme dy orë. Pra, mbas korporatës t'i rikthehemi përsëri kësaj çështjeje, në qoftë se vjen... Nëse nuk ka shanse, pastaj...

Arben Ahmetaj – Ju lutem! Deputeti po bën një kërkesë, le ta... Kemi punë dhe gjërat nuk janë gjithmonë ashtu siç duken.

Artur Roshi – Ideja është të bëhet me një lloj... Ai kishte një pretendim dhe për të pasur një... Kështu them unë...

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, faleminderit!

Ka dy dokumente zyrtare dhe janë publikuar. Ka një vendim të Këshillit të Ministrave të shoqëruar me relacion.

Nuk ka detyrim ligjor Këshilli i Ministrave të sjellë në Kuvend procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave apo videon. Kjo nuk është pjesë e ligjit, pra nuk kërkohet. Kërkohet vetëm vendimi.

Në qoftë se zoti Malaj do të vazhdojë procesin, me të drejtën e tij, mund t'ia kërkojë Këshillit të Ministrave. Është diskrecion i Këshillit të Ministrave t'ia japë ose jo. Kjo është një gjë që nuk na takon neve. Ne e votuam propozimin për shtyrje. Propozimi për shtyrje u rrëzua. Kështu që, do të më duhet të vazhdoj votimin.

Do t'ju lutem...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotit Malaj? Ai nuk është këtu.

Do të më bëni mua?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Krenar Ryci – Faleminderit, se Ben për Ben ishit!

Nga ana e procedurës ligjore del hapur dhe qartë se nuk ka ndikuar sadopak prezantimi apo mosprezantimi i tij. Cili është shkaku kryesor që ka penguar këtë institucion nga kjo goditje e zotit Malaj? Pra, si procedurë ligjore, them se ai nuk ka shkelur ligjin, se duhen fakte dhe prova. Ne japim opinione dhe jemi pak të nxituar. Megjithëse bordi do ta shqyrtojë më drejtë nga ana ligjore, sipas kodit, them se nuk ka ndonjë shkelje procedurale. Edhe në Strasburg dhe kudo ta çojë, ai do të fitojë.

Arben Ahmetaj – Jemi në...

Krenar Ryci – Ju garantoj se do ta fitojë, sepse nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë. Mund të ketë qenë një thyerje disiplinore, por ky nuk është thirrur ndonjëherë nga bordi.

Arben Ahmetaj – Më falni, jemi në mbyllje të...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di. 4-vjeçar.

Më fal! Të fokusohemi te thelbi. 28 deputetë kanë iniciativën e tyre dhe e kanë depozituar në Kuvend. Iniciativa ka shkuar te Këshilli i Ministrave. Këshilli i Ministrave e ka diskutuar brenda për brenda. Ka marrë vendimin nr.766, 3.12.2019 dhe na e ka sjellë në komision. Ne votojmë për ta çuar në seancë. Seanca do të vendosë nëse do ta shkarkojë zotin Malaj ose do të rrëzojë pretendimet e Këshillit të Ministrave.

Në fund të fundit, ky nuk është gjyq, nuk është as hetuesi. Kjo është një dëgjesë. Ju e patë që ne ruajtëm qetësinë dhe etikën, sepse e kemi detyrim ligjor dhe detyrim moral, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të jetë pasnesër, sepse ka kufij kohor procesi.

Kush është pro vendimit të Këshillit të Ministrave? Kundër?

Atëherë, të bëhet procesverbali dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Korabi nuk është prezent.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju lutesha të mos më bëni akuza që kanë të bëjnë me kufirin midis pozitës dhe opozitës!

Në rregull, atëherë.

U administrua? 12 me 5?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rezultati është 12 me 5, pro vendimit të Këshillit të Ministrave. Kështu duhet të shprehemi. Ia kalojmë seancës për vendimmarrje finale.

Dakord.

Faleminderit!

Të ftohet media! Ndërkohë, sa të vijë media...

(Mungesë regjistrimi)

Vazhdojmë.

Për rekord edhe të shërbimeve audiovizuale të Kuvendit, në përfundim u shqyrtua për vendim në bazë të procedurës vendimi i Këshillit të Ministrave nr.766 për vazhdimin në seancë të procesit të shkarkimit të zotit Arben Malaj nga Bordi i Bankës së Shqipërisë. Rezultati doli 12 vota pro vazhdimin të procedurës për shkarkim dhe dërgim të vendimit të Këshillit të Ministrave në seancë për të votuar përfundimisht dhe 5 vota kundër.

Kështu që, pas këtij votimi, seanca do ta shqyrtojë këtë çështje ditën e mërkurë, në mos gaboj, në parlament, në orën 10:00.

Faleminderit!

Ky ishte një njoftim për mediet.

Vazhdojmë me dekretin e Presidentit për Korporatën e Investimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një diskutim dhe votim për dekretin, për t'ia kaluar seancës për votim përfundimtar.

Zonja Reme Lala, ju lutem, si relatore, do t'ju lutesha të flisni shkurt, sepse e kemi bërë debatin gjatë!

Faleminderit!

Reme Lala - Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë shkurt do të flas. Nëse është e nevojshme, mund të hyj edhe në detaje të të gjitha pretendimeve të bëra nga Presidenti, megjithatë po e them vetëm me dy fjali.

Ky projektligj është hartuar në mënyrë të detajuar në bashkëpunim me grupin e universitetit të Harvardit, me një konsultë të gjerë me Bankën Europiane të Investimeve dhe Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Ky ligj është dakordësuar dhe ka reflektuar të gjitha komentet e Këshillit Europian. Si i tillë, mendoj se nuk ka vend për ndërhyrje të tjera në ligj, ashtu sikurse pretendohet në dekretin e ardhur nga Presidenti.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka ndonjë koment nga...?

Po...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Artur Roshi – Do të thosha se ne duhet të përfitojmë nga kthimi i dekretit dhe duhet ta rivlerësojmë me objektivitet qëndrimin tonë, përtej emocioneve të pushtetit dhe duhet t'i kthehemi logjikës së tregut.

Korporata e Investimeve është jashtë logjikës së tregut dhe nuk afektohet asnjë këtu, as nga ekspertët e Harvardit, as nga ekspertët e tjerë, që u përmendën nga relatorja. Ekspertët shikojnë çfarëdolloj gjëje t'u vësh para, por nuk bëjnë politika. Kështu që, këtu ndahemi.

Kjo është një politikë ekonomike, që sjell pasoja në një politikëbërje të caktuar ekonomike. Kështu që, do t'ju bëja thirrje ta vlerësojmë me seriozitet dekretin e Presidentit dhe jo thjesht ta shikojmë si një procedurë për ta kaluar dhe për ta lënë në stanjacion mendimin e tij.

Sigurisht, Presidenti ka qenë korrekt edhe në procedurë, është ndalur edhe në procedurë, por ajo që bie në sy është shkelja e lirisë së tregut. Liri e tregut, nga krijimi i këtij institucioni, pra Korporata e Investimeve, do të thotë se ajo do të ketë shërbime ekstra, do të ketë vëmendje ekstra nga qeveria dhe nuk do të jetë si një person juridik që garon në tregun e lirë.

Ku kthehemi këtu? Sipas mendimit tim, gjithmonë kthehemi në ndërmarrjet e dikurshme shtetërore, ku ato vetë bëjnë projekte, vetë bëjnë zbatime, vetë bëjnë shitjen e pronave, vetë bëjnë blerjen e pronave, pra shtimin ose pakësimin e aseteve, gjë që nuk ka lidhje me kontekstin e kohës ku jetojmë.

Për të shkuar edhe më tej, mendoj se ngritja e kësaj korporate gllabëron çdo qelizë të mbetur të ekonomisë shqiptare, të lënë jashtë vëmendjes së PPP-ve. Pra, ato që i nuk kapin dot PPP-të, i kap kjo korporatë. Do të thosha se është shumë e dëmshme për ekonominë. Këtu do të jemi.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Roshi!

A ka ndonjë koment tjetër? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është pro dekretit të Presidentit? Kundër?

Dekreti i Presidentit për Korporatën e Investimeve rrëzohet në komision dhe i kalohet seancës për të marrë vendimin përfundimtar.

Faleminderit!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Faleminderit medieve!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti